

# PËLLUMB KULLA

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

14-2

98



skeçe  
monologë  
pjesë me një akt

814-2

K 98

PËLLUMB KULLA



DIPE SHTOGU  
NË LISTË...

Skeçe  
monologë  
pjesë me një akt

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## TAKIM NË RRUGË

ARBENI — drejtor

NEVRUZI — shoferi i tij

STATHI — nëpunës i dërguar në prodhim

*Një rrugë fshati. Gazi i fermës është prishur dhe Nevruzi mundohet ta ndreqë. Arbeni i rri pranë.*

NEVRUZI — Ptu!... Na hapi punë. Është çarë gomina, shoku drejtor. Nuk kam as rezervë!

ARBENI — S'të ndodhet ndonjë shuall?... Në oficinë këto i riparonim gjithnjë më shuall të zakonshëm.

NEVRUZI — Nuk kam. Në këtë rrugë fshati, nuk kalojnë as makina.

ARBENI — Atëherë, hidhu në xhade dhe prit ndonjë shok tëndin. Ndërkohë unë po e çmontoj. *(Merr kominoshet e Nevruzit.)*

NEVRUZI — Jo, jo, shoku Arben. Në asnjë mënyrë! *(I tërheq kominoshet.)*

ARBENI — *(Duke i tërhequr edhe ai.)* Pse?

NEVRUZI — Po e teprojmë më duket. Kjo është puna ime... Ohu! Çmontimi ka telashe. Duhet futur poshtë... Mos harro se je drejtor!  
*(Ia merr përsëri kominoshet.)*

ARBENI — Dhe ti mos harro se jam mekanik me të shtatën. *(Duke ia marrë përfundimisht kominoshet.)* E kur prishet makina, unë s'do të rri të marr pozat e drejtorit... Nisu. Na merr edhe cigare atje në klub.

NEVRUZI — Të them të drejtën, shoku Arben, po më tallin shokët. Lum ti, thonë, ti je i vetmi shofer që e ke gjithnjë mekanikun me vete. Ika! *(Del.)*

*Nevruzi largohet. Arbeni nxjerr çelësat, fillon të vishet. Stathi me pantallona përveshur, me një biçikletë për dore i afrohet.*

STATHI — *(Mbështet biçikletën në një pemë.)* Statistikat thonë se në çdo tridhjetë kilometra do të gjesh një shofer duke riparuar makinën. Dhe unë gjeta tamam makinën që më duhet.

ARBENI — Përse ju interesojnë makinat?

STATHI — Mua më interesojnë drejtorët. Dhe në këtë rast interesohem për drejtorin e fermës, shokun Arben. Ku është? S'po e shoh.

ARBENI — Hm... Shkoi të blejë cigare.

STATHI — Po e pres... Më së fundi, e zura. Nuk e gjen në zyrë në asnjë mënyrë. Nuk kam hasur njeri të tillë. Shtatë ditë rresht, unë në orën shtatë te dera e zyrës — ai hiç! Dera me kyç. Rrezik t'i ndryshken menteshat. Më thanë që del nëpër sektorë. O burra

unë nëpër sektorë! Unë në sektorin një, ai te treshi! Unë te treshi, ai te njëshi! Unë kthehem te njëshi, ai, fësht, te dyshi! Thonë se ka qenë, hm mekanik.

ARBENI — E, mekanik.

STATHI — (*Duke qeshur nën hundë.*) Mekanik, hm... Djalë! Administrata është art më vete. Të drejtosh një ndërmarrje, duhen aftësi të veçanta. Nuk ke të bësh me vidha... me... pinca! Ja, edhe ti që je një copë shofer, mund ta kesh nuhatur sa vlen ai. Si të duket? Vërtet që punët e fermës i ka vënë në vijë, po mekaniku mekanik është! E? Ia thotë? Ë, thuaje... Po hapur ama.

ARBENI — Cili je ti?

STATHI — Hajde se nuk na del fjala. Dhe unë i fermës jam!

ARBENI — I fermës? Ku punon?

STATHI — Asgjëkundi akoma. Kam qenë në një ndërmarrje, në administratë. Më qarkulluan në fermë.

ARBENI — Në fermë? Që të forcohet puna?

STATHI — Jo. Që të forcohem unë.

ARBENI — Të dërgoi kolektivi?

STATHI — Po, po! Më emërtuan burokrat. Të vejë në prodhim, thanë. U votua: nëntëdhjetë e nëntë pikë tre për qind, ishin pro, zero shtatë për qind kundër.

ARBENI — Cili qe ai që votoi kundër?

STATHI — Unë. Zeroshtatëshi!

ARBENI — (*Duke u futur nën makinë.*) E di ç'them unë, shoku zeroshtatësh? Drejtorin mos e ndiq. Ai do të vijë vetë atje ku do të punosh ti. Ti fillo!

STATHI — Pa biseduar me të?! Në asnjë mënyrë.  
E bukur këshillë! Flet kaluar ti, o shofer vëllai, se ma ke drejtorin një pëllëmbë larg dhe ta sheh punën.

ARBENI — E mo, se puna duket kudo që të jesh.

STATHI — Duket, s'them jo. Po më mirë kur ta sheh direkt drejtori... Ja, ti je futur nën makinë, je ngallosur me vaj. Ngallosu, më shumë ngallosu! Punë e madhe!... Po ama të sheh drejtori. Punon, thotë.

ARBENI — Jo, more! Dhe unë i marri, shumë defekte shkoj e i riparoj natën kur s'më sheh ai!

STATHI — Jooqo! Jo, dëgjomë mua! Bile, bile, ndonjëherë në mes të rrugës ndale makinën: gërdap! U prish, thuaj. Kot! Futu poshtë makinës... Kot! Gjoja ka defekt!

ARBENI — Mirë thua. (*Gjoja duke u kujtuar.*) Uuuu, po ai është vetë mekanik!

STATHI — Ishte!!! Tani është drejtor. Më therrë mua po u përkul një gisht. Hiç, ore, fare! T'u them këto se janë sekrete të eksperiencës sime me drejtorët. (*Psherëtin gjatë.*)

*Pauzë. Arbeni punon.*

STATHI — Si sillet ai, mo?

ARBENI — Kush?

STATHI — Drejtori.

ARBENI — Çka, mirë.

STATHI — Një shok imi thoshte që në çdo shtatë drejtorë, njëri është brutal.

ARBENI — Ndryshojnë statistikën, shoku zero...

STATHI — Shoku Stath!

ARBENI — Ndryshojnë, shoku Stath. I përmirëson koha,

STATHI — A! Statistikat kanë logjikën e tyre, sho-ku shofer. Unë u besoj pa rezerva. Për shembull, ca kohë punëtorët ankoheshin se disa nga dushet e banjave ishin bllokuar. Unë s'leviza nga zyra. Në fund të muajit pashë faturën e konsumit të ujit: ankesa kishte qenë e drejtë. Mora masa!

ARBENI — *(Duke dalë që poshtë makinës.)* Shiko, shiko! Po tani, çfarë ke ndër mend t'i thuash drejtorit?

STATHI — Do të më ndihmosh?

ARBENI — *(Konfidencial.)* Në çdo tre shoferë drejtorësh, njërit i ecën fjala te drejtori.

STATHI — Vërtet? *(I afrohet.)* Mbase ka ndonjë punë të vockël.

ARBENI — Ka, posi! Patjetër ka.

STATHI — Po punë ka, unë e di. Po një punë... zyre! Unë s'kam pretendime për zyrën. Absolutisht! Se do t'i duhem. Do ma ketë nevojën.

ARBENI — Nevojën nuk besoj të ta ketë.

STATHI — Ëhë. Eksperiencia ime...

ARBENI — Ajo është një eksperiencë pa vlerë. Shoku Stathi, ti bie erë që atje tej që je burokrat!

STATHI — Burokrat the ti, apo s'jam në rregull me veshët?

ARBENI — Jo, jo! Ke veshë të mrekullueshëm.

STATHI — Dua dru unë që vete e bisedoj me ty! Ku merr vesh ti, more! Një copë shofer je aty!... Unë i qaj hallin, ai... Po mirë thonë: në çdo katër shoferë, një është i pasjellshëm... Si s'pata fat të gjej ndonjë nga ata tre të tjerët.

ARBENI — Dëgjo, shoku Stathi!

STATHI — As që dua të të dëgjoj. Njeri pa takt. Dukesh që nga kominoshet ti!

ARBENI — Unë dua të të them...

STATHI — Hiç mos më thuaj!... Qepe! Shtërngo timonin, djalosh, e mos fut hundët atje ku s'të takon! Oj! Unë po pres drejtorin. Ah, ja ku po vjen! (*I del përpara Nevruzit.*) Me leje?

NEVRUZI — Hë, vëlla, si e ke hallin?

STATHI — Ju falemnderit për shprehjen «vëlla»! Unë dua të bisedoj me ju.

NEVRUZI — Një minutë, sa t'i çoj gominën drejtorit.

STATHI — Çojani. (*Percepton me vonesë.*) Eh? Drejtorit?!

NEVRUZI — (*Arbenit.*) Merreni, shoku drejtor. Po më fal se më kërkojnë. (*Stathit.*) Urdhëro, vëlla!

STATHI — More, lëre vëllanë se s'po merret vesh këtu. Unë s'po dalloj cili është shofer e cili drejtor. Ore, unë dua të bisedoj me Arbenin!

NEVRUZI — Ja Arbeni. Këtu e kishe. Nuk biseduat?

STATHI — (*I dërrmuar.*) Biseduam!

ARBENI — Biseduam.

STATHI — Biseduam. (*Arbenit.*) Shoku Arben! Unë i marr mbrapsh fjalët që thashë.

ARBENI — Kurse unë të miat jo. Shkoni, shkoni, shok... Filloni punën. Ajo është e nevojshme për ju.



STATHI — Hm... Në çdo tre keqkuptime...

ARBENI — Në çdo shtatë burokratë, patjetër duhet të shkojnë në prodhim që të shtatë!



## E PROVOI NË KURRIZIN E TIJ

BABAI  
NËNA  
DJALI  
DREJTORI I KANTIERIT  
NORMISTI

*Ngjarja zhvillohet në një apartament të ri të porsadorëzuar. Pjesëtarët e familjes po punojnë për pastrimin dhe sistemimin e dhomave.*

BABAI — Luajini pak duart se do të na vijë për urim drejtori i kantierit me normistin.

NËNA — Nuk po'ngopem së pari shtëpinë e re... Tani do të martoj dhe djalin... Këtë dhomë do t'i japim djalit me nusen, ë?

BABAI — Këtë, këtë. Kjo është më e mira!

NËNA — Petrit!

*(Vjen djali me kovë e qëndron te dera.)*

DJALI — Urdhëro, nënë!

BABAI — E, more qeratai i babait, të pëlqen kjo dhomë?

DJALI — Më pëlqen, pse?

BABAI — Këtu do të të martojmë... Këtu do ta kalosh muajin e mjaltit.

DJALI — Oooooh! *(Skuqet.)* Opo dhomë të jetë, sikur...

BABAI — E, kur je i ri nuk pyet... Të kesh nusen pa dhe ahuri të duket pallat.

DJALI — Të lutem, baba!

BABAI — Hajt, hajt se e di unë... Këtë dhomë e ke të mirë... E kam punuar me duart e mia... Gjithë apartamentin... Vetë i ngrita muret, vetë e bëra suvatimin, shtrimin e pllakave. Vetë i montova dyert...

NËNA — Ta dije ti atëherë se do të të jepnin këtë apartament...

BABAI — E ku ta dija. Mund të më jepnin këtë, mund të më jepnin një tjetër... U dorëzuan me qindra... Morëm para atëherë, që u kërdisëm... Habitej dhe normisti... Uh, m'u kujtua normisti... Shpejt se do të vijnë të na urojnë!

*Rifillon punën. Djali kalon dhe pengohet në një pllakë parketi të vendosur keq. Gati bie.*

DJALI — Baba! Edhe parketin ti e ke shtruar?

BABAI — Dhe parketin, dhe parketin, posi! Pse?

DJALI — Hiç! Hiç! Kot. *(Duke fërkuar majën e këmbës.)* Kot fare.

- NËNA — Ti, Selami, na vër ca gozhdë këtu të vendosim fotografinë e djalit dhe të nuses...
- BABAI — Patjetër... Qoftë e hairit!
- DJALI — Unë po ngul ca gozhdë matanë për zbu-  
kurime. *(Del.)*  
*Babai godet gozhdën në mur. Dëgjohet zhur-  
më e shurdhër nga dhoma tjetër.*
- DJALI — Aaaaa!
- BABAI — Ç'pate?
- DJALI — Ra gjysma e suvasë këtej.
- BABAI — Vërtet? Ç'thua, more! *(Mbetet ngushtë.)*
- NËNA — *(Te dera.)* Ç'është kjo suva kështu? Ti e  
ke bërë?
- BABAI — Unë, e ç'do të thuash?
- NËNA — Hiç, hiç, vazhdo!  
*Nëna niset të vejë në dhomë po pengohet në  
parket. Ajo fluturon drejt e në krahët e bu-  
rrit. Në derë duken drejtori dhe normisti, i  
cili mban një pako në duar.*
- DREJTORI — *(Shokut.)* Ç'janë këto përqafime në  
mes të ditës?
- NORMISTI — Janë shumë të mallëngjyer.
- BABAI — *(Shikon mysafirët.)* E po mjaft, moj  
grua, tani... Shyqyr që ia arrite kësaj dite...  
Urdhëroni, urdhëroni!
- DREJTORI — Urime!... Urime!... *(Pengohet dhe  
fluturon në krahët e të zotit të shtëpisë. Me  
atë rast puthen e përqafohen.)*
- BABAI — Faleminderit, shoku drejtor, faleminderit!  
*Normisti i dorëzon pakon nuses dhe i uron  
të gjithë.*
- DREJTORI — *(Duke fërkuar majën e këmbës.)*  
Parket nga i Elbasanit është ky?
- BABAI — Nga i Elbasanit, si urdhëron!...

NORMISTI — E, po si e ndieni veten në shtëpinë e re?

NËNA — Shumë mirë.

DREJTORI — T'i gëzoni!

NORMISTI — Të rrini gëzuar!

*Dëgjohet një zhurmë. Hyn djali. Në kokë ka copëra llaçi.*

BABAI — Si është puna?

DJALI — Ra një copë nga suvaja e tavanit të kuzhinës. Ata gjitonët lart si duket po hedhin valle nga gëzimi.

DREJTORI — Sa keq! Cilësi e dobët!

NORMISTI — Ja pra, shumë keq. Na ka shpëtuar.

DREJTORI — Cila brigadë ka punuar këtu?

NORMISTI — Nuk më kujtohet. Do të shikoj në regjistër dhe do t'ju them.

BABAI — O po hiç mos e shih. Kot... Ajo që u bë u bë... Të gjithë kemi përgjegjësi.

NORMISTI — Jo, jo, pse? Ta dimë. Ti ke punuar mirë, shoku yt keq. E pse ta vuash ti? Ta gjejmë cili është dhe ta nxjerrim para kolektivit.

BABAI — Dëgjoni mua. As mos e hapni këtë muhabet... Unë nuk ankohe... Do ta meremetoj me duart e mia.

DREJTORI — Jo kështu, Selam... Je shumë zemërgjerë.

BABAI — E di, jam, zemërgjerë jam...

NËNA — Gabim e ke... Le ta gjejnë këta shokët, pse? Po e mbuluat, ai do të punojë shkel e shko...

BABAI — Nuk punon shkel e shko, jo! Më besoni mua... Lërmani mua në dorë... E rregulloj unë.

DJALI — Ata gjitonët u futën te kjo dhoma përmbi ne... Dëgjoj këmbët! *(Të gjithë i mbajnë sytë lart në tavan.)*

- DJALI** — Unë nuk e kuptoj. Valle hedhin ata?
- DREJTORI** — Dhe këtë tavan po ajo dorë e ka punuar?
- NORMISTI** — Po ajo, besoj.
- DREJTORI** — Epo do të na falni nëse...
- NËNA** — Po nuk pitë asnjë kafe.
- DREJTORI** — Kemi pirë mjaft... Kemi dhe ca urime të tjera. Hajt, e gëzofshi dhe t'ju trashëgohet djali! *(Del.)*
- NORMISTI** — Urime, urime dhe djali t'ju trashëgohet! *(Del edhe ai me nxitim.)*
- NËNA** — Më një fjalë, Selam, ti na i dëbove miqtë.
- BABAI** — Unë?!
- DJALI** — Ata patën frikë nga suvaja...
- BABAI** — Ore, si e keni hallin ju?! Doni të bëj autokritikë, ëh! Keni filluar që në mëngjes. Ti e ke bërë këtë? Ti atë? Unë e kam bërë... Unë, unë, unë! Doni më? Pale, kjo kishte qejf të më nxirrte para kolektivit!...
- NËNA** — Pse të mos dalësh... Kur punove shkel e shko pa u strehuar ti... Mendo se si do t'ia shkëlësh më vonë.
- BABAI** — Tani që e provova në kurrizin tim... po nuk i kënaqa ata që do të strehohen mos më thëncin Selam, por haram... Dhe pastaj pas ca vjetësh dhe ne do të zgjerohemi, apo jo... Sot jemi tre po do të martojmë djalin e do të bëhemi trembëdhjetë.
- DJALI** — *(Te dera.)* Oooh! Baba, lëri ëndërrimet. Më mirë më thuaj a do të mbajë kjo suvaja se mos na palosë që natën e parë.
- BABAI** — Mban, mban... Nuk e kam shkelur në të gjitha, jo!

ZËRI I NËNËS — Selam! Selam! Hajde të mbyllim portën e apartamentit. Nuk e lënë derën pllakat e korridorit të lëvizë.

BABAI — He, dreq, o dreq... Erdha, erdha!

*Djali del, pas tij nisët babai. Pengohet për herë të fundit në parket dhe fluturon jashtë.*



## XHA NAZIFI ROJË

XHA NAZIFI — roja e ndërmarrjes  
LAZJA — llamarinist

*Dhoma e rojës. Dimër.*

XHA NAZIFI — Punëtorët u larguan... Po vonon të dalë vetëm Lazja. Troç hesapi, mua kjo s'më pëlqen... Punon më shumë nga të tjerët ai?... Jo!... Punojnë të tjerët që u puthça dorën, i di unë, i di. Roja e natës të tëra duhet t'i dijë... Lazja ka tri net që del i fundit. S'më pëlqen... Del i mbështjellë trashë me pallto... (Nuhat.) Hëm, hëm, çoç ka aty... Ndonjë copë llamarinë xingato! Zor më vjen të mendoj për tjetrin kështu... Me sy s'e kam parë... Po hunda hëm, hëm, ma ndien. Ja po vjen... I mbështjellë. Tundu,



Nazif... Je rojë. Po kujdes ama... Le të ta thotë hunda. Ki kujdes! (*Duket Lazja.*) Hë, more Laze, shokët ikën.

LAZJA — Ja, xha Nazif, tani mbarova.

XHA NAZIFI — I fundit je?

LAZJA — I fundit.

XHA NAZIFI — Nxitohesh?

LAZJA — Jo. Pse?

XHA NAZIFI — Ke ndonjë hall, ndonjë nevojë?

LAZJA — Asgjë. Pse pyet?

XHA NAZIFI — Ja, të rrish ndonjë gjysmë ore këtu me mua.

LAZJA — Po si jo. Si e ke hallin?

XHA NAZIFI — Pritet një kontroll nate në repart. Më tha drejtori në telefon: «Mbaj ndonjërin aty. Nuk besoj të bëhet, po ti mbaje ndonjërin nga shokët aty pranë telefonit. Pas një gjysmë ore le të ikë.»

LAZJA — Hiç mos e zgjat, rri unë.

XHA NAZIFI — Ashtu! (*I fut dru zjarrit.*) Ftohtë!

LAZJA — Thëllim.


XHA NAZIFI — Këtu mos u tremb. Dru kam... Dhe furnelën e ndezim. (*Fut spinën në prizë.*)

LAZJA — Ama, punë e qetë kjo e rojës, Xha Nazif.

XHA NAZIFI — E qetë, e qetë, or ti Laze. (*I fut dru zjarrit.*) Shyqyr! Roja-rojë! Ruan! Po, është punë e lehtë se tani njerëzit e ruajnë vetë pronën e tyre. Si sytë e ballit... U dhimbset... Është e tyrja.

LAZJA — Ashtu, ashtu! (*Fillon të fshijë djersët.*) Të gjithë ne i bëjmë sytë katër.

XHA NAZIFI — Shumë mirë! Sytë e mbyllur s'janë sy. Katër t'i bëni! Unë do t'i bëj katër-



mbëdhjetë... Se armiq kemi, po edhe të krimbur kemi. Shkon tjetri dhe merr një tub a një copë llamarinë... Pse? Pse, or qen, t'i thuash! Jona është... Me të realizohet plani. Plani e bën ndër marrjen të fortë, shoqërinë të pastër... Rritet mirëqenia... Ty s'të durohet... E do veç ti... Më parë se të tjerët. Përse ta marrësh llamarinën?

LAZJA — Kush? Unë?

XHA NAZIFI — Fjala vjen... Ke vapë?

LAZJA — (*Duke fshirë djersët.*) Jo!... S'po bie telefoni.

XHA NAZIFI — (*Duke i futur prapë dru zjarrit.*) Presim dhe ca. Roja duhet të ketë sy, veshë dhe hundë të fortë.

LAZJA — Hundë?

XHA NAZIFI — Po, po! Hundë. Nuhatje... Hëm... hëm... se ka gjëra që nuk i sheh syri dhe nuk i dëgjon veshi. Atëherë mua më ndihmon hunda. (*Nuhat.*) Ore Lazë! T'u bëftë, xha Nazifi! Hiqe pallton se kur të dalësh do të ftohesh!

LAZJA — Jo, jo!

XHA NAZIFI — Roja i vërtetë duhet t'i njohë njerëzit mirë. Jo si ca roja që marrin gunën dhe rrinë pranë telefonit e pranë zjarrit. Jo! Dhe në mbledhje të vejë roja. Si vete plani?... Kush punon, kush dallohet?... Ku çalon puna?...

LAZJA — S'po bie telefoni.

XHA NAZIFI — S'po bie.

LAZJA — Të dal nië minutë jashtë?

XHA NAZIFI — Po ti the se nuk kishe asnjë nevojë!



LAZJA — Më pihet ujë.

XHA NAZIFI — (*I jep poçin e ujit dhe gotën.*) Sapo e mbusha. (*Lazja pi.*) Të tëra këto i di xha Nazifi. Dhe matem mirë unë, se mbase tjetri s'ka marrë gjë... Turpërohem me shokun kot. (*Zbërthehet, kurse Lazja bën fresk.*) Por ama, kur sigurohem, kur hunda thotë po, syri po, veshi po, i them pa një pa dy: Ç'ke aty nën pallto?

LAZJA — Kush? Unë?

XHA NAZIFI — (*I sigurt.*) Po, ti!

LAZJA — Lllamarinë.

XHA NAZIFI — Xingato?

LAZJA — Xingato.

XHA NAZIFI — Nxirre!

LAZJA — (*Zbërthehet dhe i nxjerr.*) Ja!

XHA NAZIFI — Ti në shtëpi ke edhe tri copë si kjo.

LAZJA — Po!

XHA NAZIFI — Nesër t'i sjellësh edhe ato.

LAZJA — Nga e kuptove ti?

XHA NAZIFI — (*Rreptë.*) Me hundë!... Ik tani!

LAZJA — Unë desha të bëja një banjë.

XHA NAZIFI — S'ke nevojë. Sonte u lave në djersë. Pa nesër do të bësh një dush të fortë që... (*Bie telefoni.*)

LAZJA — Po bie telefoni.

XHA NAZIFI — S'ke punë ti. Ka rojë këtu! Nisu! (*Lazja del. Xha Nazifi merr telefonin.*) Këtu roja e ndërmarrjes Nazif Shqekëza. Çdo gjë në rregull, shok... Gjumë të ëmbël! Ty, ty, jo mua! Për mua s'ka gjumë. Jam në krye të detyrës!...

## RRUFEJA NUMËR PESËMBËDHJETË

SHEMJA — kryetari i kooperativës

LEMJA — anëtar i kryesisë

TEMJA — « i »

TEFTA

PERSONA TË TJERË

*Dy njerëz vijnë me vrap duke bërtitur.*

*Në skenë është vetëm kryetari.*

LEMJA — Shoku kryetar!

TEMJA — Shoku kryetar!

LEMJA — Shoku Sheme!

TEMJA — Shoku Sheme!

SHEMJA — Hë more, ç'është?

LEMJA — Erdhën!

TEMJA — Erdhën!

SHEMJA — (I alarmuar.) Seriozisht! Erdhën? Ku janë? Sa janë?

TEMJA — Janë nja pesë a gjashtë, për nder...

LEMJA — Ka nga seksioni i bujqësisë, nga kooperativa fqinjë. (Të tre duken në paraskenë dhe bëjnë sikur shohin nga dritarja e imagjinuar. Janë të alarmuar.)

SHEMJA — (Pa i ndarë sytë nga ata që po vijnë.) I shoh. (I prerë.) Përgatituni, guxim!

LEMJA, TEMJA — E dimë vetë, ne.

SHEMJA — Pajisuni dhe... pas meje. Vrap t'u dalim përpara.

(Shpërndahen me nxitim. Skena për një çast mbetet bosh, pastaj nga një anë hyjnë mysafirët.)

TEFTA — Këta kanë tokë të mirë, nuk justifikohen dot.

DIKUSH — Ashtu është.

TEFTA — Një dhe dy e «s'na mbajti moti, s'na ndihmoi koha, na dëmtoi shiu».

DIKUSH — Edhe vjet kështu.

TEFTA — Të gjitha kooperativat i tejkaluan shifrat e prodhimit, këta jo... Kryetari, shoku Sheme, na ka thirrur ta shohim gjendjen në vend. E ç'të shohim?

DIKUSH — Ja po vijnë... (Vijnë Shemja, Temja, Lemja. Janë veshur me çizme dhe pajisur me çadra.)


SHEMJA — Mirë se erdhët! Njihuni! Këta janë dy anëtarët e kryesisë Lemja dhe Temja.

TEFTA — Qenkeni pajisur paq, more shoku Sheme.

SHEMJA — Kemi një kohë shumë të pabesë, moj shoqja Teftë... Seriozisht! Këtu del diell,

thua ti: bukuri! Aty për aty fillon shiu me litarë. Del lumi, të mos e kesh mendjen, të merr.

LEMJA — Të merr.



TEMJA — Të merr, për nder, të merr.

TEFTA — Qenkeni në hall të madh. Ruhuni mos ju marrë.

SHEMJA — Si urdhëron, e kemi merak vetë. Kë-të vit e nisëm mbarë. Do ti bum shiu, doli ujët, u përmbytëm.

LEMJA — Det, ore det! Keni parë ju?

TEMJA — Det, për nder, det. Kemi vënë vizën. Ja, do ta shihni.

SHEMJA — Ne çdo gjë e kemi të dokumentuar. Leme, pasqyrën.

LEMJA — Urdhëro! (Nxjerr nga dosja një letër dhe ia zgjat kryetarit.)

SHEMJA — (Duke i hedhur një sy pasqyrës.) Sipas

evidencave të përpiluara, të dokumentuara dhe me procesverbale të rregullta, sivjet mbi arat e kooperativës sonë u derdhën katërqind e dyzet e shtatë rrëke shiu, nga të cilat 18 ishin të mëdha ose me gjym, siç thotë populli. U bënë dy përmbytje, njëra nga të cilat shumë e madhe. Edhe sot, mbi një mur, kemi vijën e shënuar deri ku pat arritur niveli i ujërave. Me bojë të kuqe. Kemi lënë shokun Teme kujdestar për atë vijë. Do t'jua tregojë. Te ne ka bubulluar 1847 herë dhe kanë rënë 14 rrufe, nga të cilat njëra përmbi kryesi, por fatmirësisht doli huq. Sidoqoftë unë nuk isha atje.

LEMJA — As unë.

TEMJA — As unë.

SHEMJA — Thatësira na ka përvëlur njëmbëdhjetë ditë. Lumi ka dalë gjashtë herë. 113 herë ka fryrë era, nga të cilat 83 nga jugu, tre nga veriu, tetë nga lindja, nëntë nga perëndimi dhe dhjetë herë kështu (*Rrotullon dorën.*) ciklon... Dëmet ishin të mëdha, prodhimet nuk i morëm dot sipas planit. Me natyrën nuk hahemi dot.

LEMJA — Nuk hahemi.

TEMJA — Nuk hahemi, për nder.

SHEMJA — Në këtë dosje kemi procesverbalet e ndryshme... Dhe tani urdhëroni të shihni vijën e kuqe që tregon se deri ku arriti niveli i ujërave... Teme, na udhëhiq!

*Lëvizin nëpër skenë deri në anën tjetër, ku në mur në një lartësi rreth dy metra e gjysmë është hequr një vijë e kuqe, e trashë, horizontale.*



- SHEMJA — Ja, shiheni vetë!
- MYSAFIRËT — Vërtet?! Kaq lart?!  
 TEFTA — Çfarë thoni kështu?! Vërtet?! Paska qenë e tmerrshme!
- SHEMJA — (*Lemes dhe Temes.*) Ore shokë! Prishni se po më habisni edhe mua. Seriozisht!  
 Pse ore, kjo është ajo vija?
- LEMJA — Kjo, shoku Sheme.
- TEMJA — Kjo, shoku Sheme, kjo.
- SHEMJA — Po sikur ka qenë më poshtë, ore.
- TEMJA — Më poshtë ka qenë, shoku kryetar, si urdhëron. Ja, ka qenë këtu po ne e shkrojtëm ajte lart se na e prishin kalamajtë... Na polli belaja, për nder! (*Mysafirët qeshin.*)
- SHEMJA — Nejse, ç'bëri atje, ç'bëri këtu.
- TEFTA — Edhe ju, shoku Demir, keni ara ngjitur me kooperativën e këtyre apo jo?
- DEMIRI — (*Duke qeshur.*) Po, shoqja Teftë.
- TEFTA — Ju as u mbytet as ju ranë rrufetë! Kështu?
- DEMIRI — Joo, shira ranë dhe era fryu, por ato janë të zakonshme. Planin e prodhimeve bujqësore ne e tejkaluam... Kemi pasur kanale kulluese, kemi rezervuar edhe gjatë thatësirës.
- TEFTA — E more shokë! Si thoni për këto? Ju keni kanale dhe rezervuarë?
- SHEMJA — Jo. Këtë e pranojmë, s'kemi.
- LEMJA — Jo.
- TEMJA — Jo, për nder, jo.
- TEFTA — Hahemi edhe me natyrën ne, shokë. Nuk i trembemi dhe fitojmë mbi të. Po ju keni një armik më të madh se natyra... Bile dy. Dembelizmin dhe burokratizmin që ju kanë zënë këmbët...

DIKUSH — Është turp.

NJË TJETËR — Justifikime të kota.

NJË TJETËR — Qesharake, thuaj...

TEFTA — Dhe atë pasqyrë, mos e gris! Jepja es-  
tradës së kooperativës si material humoris-  
tik. Tungjatjetani dhe i shikoni më thellë  
punët!

SHEMJA — Po kjo rrufe!

LEMJA — E pesëmbëdhjeta.

TEMJA — Mbi kryesë.

SHEMJA — Po këtë radhë ne ishim brenda. (*Fi-  
llojnë të dalin.*)

TEMJA — Shoku kryetar! Shi! Shi, për nder,  
shi: Një pikë, ja!

LEMJA — Shi, shoku kryetar. Filloi... T'u thërre-  
sim, t'u themi...

SHEMJA — Aha, s'pi ujë më kjo punë. (*Hap çad-  
rën. Lemja e Temja hapin edhe ata çadrat  
dhe dalin pas tij.*)

## TRAKTORISTËT

DALLËNDYSHJA - e zyrës së planit të  
SMT-së

HALITI - traktorist

FRANVERA - traktoriste

BASHKIMI - traktorist

*Te qendra e emulacionit. Dallëndyshja hedh shifrat e kursimit të karburantit nga letra që ka në dorë në tabelën mujore, bri emrave të traktoristëve.*

HALITI - (Afrohet.) Hë, Dallëndyshe, ç'kemi?

DALLËNDYSHJA - Ja, po nxjerr shifrat mujore të kursimit të naftës nga ju traktoristët.

HALITI - Si dukemi?

DALLËNDYSHJA - Shumë mirë, Ju lumtë!

HALITI - (Duke parë tabelën.) Ehtë... Unë qen-

kam nga fundi... Pak kam kursyer... Po ata të dy si janë?

DALLËNDYSHJA — Bashkimi ka kursyer 15 litra më shumë.

HALITI — O o o o ... E bukur! Kushedi sa do të nxehet Pranvera. Apo nuk ka një sendër ajo që...

DALLËNDYSHJA — E de! S'ka pse të nxehet. Fundja vetëm ai ia ka kaluar. Ajo vjen e dyta.

HALITI — Halli se ajo do që të jetë e para.

DALLËNDYSHJA — Epo ai nuk është dokushdo, por djali që ajo...

HALITI — Kjo nuk dihet.

DALLËNDYSHJA — Këtë e kanë kuptuar të gjithë.

HALITI — Ai e do... Ma ka thënë vetë... Kurse ajo nuk kuptohet.

DALLËNDYSHJA — Dhe ajo, me siguri... Ai është deli djalë... Duket sikur hahen e grihen, por kjo s'është veçse sedra e garës së kursimit. Kjo është gjë e mirë.

HALITI — Bile shumë e mirë, shumë e bukur... Nga tërë muajt e vitit ai ia pat kaluar asaj gjashtë herë, kurse ajo pesë herë. Ja tani... ai prapë... 15 litra.

DALLËNDYSHJA — U qafsh hallin atyre ti. Pas fushatës së mbjelljeve, prite kur t'u hamë dasmën. U kthyen të gjithë?

HALITI — Ja po vijnë ca nga ca... Tani do mbli-dhen këtu. Ikim?

*Ato largohen. Vjen Bashkimi. Shikon tabelën dhe i kënaqur ndez cigaren. Pastaj hiqet mënjatë se sheh që tabelës po i*

afrohet me kureshtje Pranvera. Ajo vjen me hapa të shpejtë, shikon shifrat dhe shfaq menjëherë nervozizmin.

BASHKIMI — (Duke i vajtur pranë.) Mirëmbërëma!

PRANVERA — Mirëmbërëma!

BASHKIMI — Si të shkoi puna sot?

PRANVERA — (Prerazi.) Mirë. (Nis të largohet.)

BASHKIMI — Pranvera! (Ajo ndalet.) Të shoh pak të mërzitur. Ç'ke? (Ndërkohë shikon shifrat në tabelë.) I paskan nxjerrë... Unë qenkam ca përpara... Do të jetë bërë ndonjë gabim në llogari.

PRANVERA — Kur ta kam kaluar unë s'ka qenë bërë asnjë gabim.

BASHKIMI — Dhe ti për këtë bëhesh nervoze?

PRANVERA — (Pa e dhënë veten.) Aspak!

BASHKIMI — (Shpirtgjerë.) Nuk ka lezet. Unë s'ta pata fare zili kur ta nxorën fotografinë në revistën «Ylli»... Bile nuk u kurseva hiç, po bleva 15 copë revista. Dhe i kam fotografitë e tua në kabinën e traktorit. Katër nga e majta tre nga e djathta.

PRANVERA — Shumë faleminderit! E pse i ke vënë?

BASHKIMI — Xhamat nuk i kam aq të puthisur dhe kam vënë fotografitë që të mos më hyjë era.

PRANVERA — Të këshilloj që të vesh nga ato artistet e kinemave.

BASHKIMI — Kam më ngrohtë me traktoriste sesa me artiste... Artistet qeshin. Traktoristet mbase janë më të nevrkosura, por kjo nuk prish punë.

PRANVERA — Do të ta them troç? Unë jam vërtet

e nevrikosur. Këtë muaj kam kursyer më shumë se çdo herë dhe prapë se prapë... Si shpjegohet kjo?!

BASHKIMI — Thjesht... Fushatën e kursimit unë e kam kuptuar më mirë politikisht.

PRANVERA — Ç'na the! Të gjithë ne traktoristët e kemi kuptuar shumë mirë.

BASHKIMI — Atëherë do të jetë edhe ky shkaku tjetër personal... S'është kaq i madh, po sidoqoftë... dua të martohem, prandaj dua ta bëj shprehi kursimin... edhe në familje.

*Pauzë*

PRANVERA — Urime! Kur?

BASHKIMI — Nuk e di.

PRANVERA — Me cilën?

BASHKIMI — Nuk e di.

PRANVERA — Po a e ke zgjedhur?

BASHKIMI — Patjetër.

PRANVERA — Cila është ajo?

BASHKIMI — E, e, e... nuk e di.

PRANVERA — Sot po ma kalon mirë në kursim... Qenka i kursyer edhe në fjalë. Ika se do t'i ndërroj vajin motorit.

BASHKIMI — Prit, Pranvera!.. Të të pyes si shoke. A meritoj unë të marr një vajzë të mirë?

PRANVERA — Pse jo. Ti je punëtor... Profesionin e zotëron mirë... je gazmor... kursimtar, po... shihet (*Tregon tabelën.*) Po se mos je i kursyer edhe në dashuri?

BASHKIMI — O, jo!... Ashtu s'kursehem unë. Dhe demek po t'ia shfaq asaj dashurinë, ajo nuk do të më thotë jo?

PRANVERA — Nuk do të të thotë.

BASHKIMI — Pranvera... Pranvera... Hm... Pranvera... Unë... (Ngec.)

PRANVERA — Ç'pate?


BASHKIMI — M'u mbarua karburanti... Më ndihmo!

PRANVERA — (Befas.) Të dua, Bashkim!

BASHKIMI — Më çlirove. Jam i lumtur... Tani ne do të jemi gjithë jetën bashkë... Dhe gjithçka do ta ndajmë së bashku... Dhe shifrat e kursimit të karburantit.

PRANVERA — Ah, të falemnderit! Nuk i dua... Gara do të vazhdojë... Dhe të shikosh po nuk të lashë prapa.

BASHKIMI — Nuk do?! Mirë. Dhe unë ja ku të them, se do të të dua pa u kursyer, në zannat do të të ndihmoj pa u kursyer e do të ta kaloj në kursimet pa u kursyer. Tani eja t'i ndërrojme vajin motorit.



## GOGOLI I DASHURISË

GJERGJI

LIRIKA

ARIFI — babai i Gjergjit

SELIMEJA — e ëma e Lirikës

ADILI — babai i Lirikës

*Në paraskenë dalin të zënë dorë për dorë  
Lirika dhe Gjergji.*

LIRIKA — Ne tani jemi burrë e grua.

GJERGJI — Jemi rritur bashkë, kemi qenë bashkë  
në shkollë dhe kemi punuar së bashku në  
arat e kooperativës.

LIRIKA — Do t'ju tregojmë historinë e martesës  
sonë.

GJERGJI — Ne duheshim prej kohësh, por nuk e  
shfaqnim.



LIRIKA — T'u thosha prindërve se unë kisha rënë në dashuri ishte njësoj si të shihnin ujin e kroit të ngjitej përpjetë në mal, sikur dielli të kthehej prapas e pulat të blegërinin si delet... si të prishej bota.

GJERGJI — Fjalën dashuri as nuk mund ta përmën-



dja në shtëpi. Unë isha djalë dhe babai s'do të kishte ndonjë kundërshtim të madh që unë të martohesha me dashuri, por halli se kisha dhe dy motra, të cilat mund të merrnin shembull... Bobo... Kjo ia ngrinte babait flokët përpjetë...

LIRIKA — Po ne kishim arsye ta donim njëri-tjetrin.

GJERGJI — Aq arsye kishim e aq në rregull ishim, sa një mbrëmje vetë babai im, pa ditur unë asgjë, ngrihet e vete të më gjejë nuse.

LIRIKA — Dhe vjen në shtëpinë time për të më kërkuar mua. Aty po binin në marrëveshje dhe unë s'dija gjë.

GJERGJI — Ne shëtisnim të dy në rrugët e fshatit nën dritën e hënës. Por ata nuk dinin gjë. (*Qeshin të dy e dalin.*)

*Në shtëpinë e Lirikës.*

ARIFI — Ta kam vërtitur edhe një herë para nja dy javësh muhabetin, o Adil. Nuk di a më ke kuptuar... Ëh! Thuajmë të drejtën!

ADILI — Jo, për shpirt të babagjyshit. Mua s'para më vete mendja lart e poshtë... Po ma the troç të kuptova, po s'ma the, mbeti.

ARIFI — Po ja, o Adil! Sikur të lidhemi ca më ngushtë. Ti ke një çupë e unë një djalë për të martuar... Eh, ja, troç hesapi!

ADILI — Ëh?... (*Qesh.*) Troç, troç... Si shumë troç ma the, po nejtë... Të mendohejmë njëherë, o Arif. (*Vjen Selimeja me filxhanët e kafesë. Ia zgjat tabakanë Arifit, pastaj të shoqit.*)

ADILI — (*Nën zë.*) Ku është ajo? Akoma s'ka ardhur?

SELIMEJA — (Po ashtu.) Ku di unë... Do të kenë ndonjë mbledhje.

ADILI — (Po ashtu.) Mbledhje, mbledhje... Atë po e kërkojnë nuse, ajo vjen në mes të natës... Po shturren njerëzit. (Me zë të lartë.) Që thua ti grua, Arifi na kërkon Lirikën për Gjergjin. Si thua ti tani? (Nxiton t'i dalë përpara.) Unë i thashë të mendohemi.

SELIMEJA — Të mendohemi them edhe unë.

ADILI — Të mendohemi! Këto punë nuk bëhen tak-fak.

SELIMEJA — Ta pyesim dhe çupën... Djalin e ke pyetur?

ARIFI — Jo! Po e di unë, s'ma prish ai... Ku ka si çupa juaj? S'gjen një në fshat... E urtë, punë-tore, shkon rrugës, ja drejt! Sytë, as kështu e as ashtu.

ADILI — Dhe ti e paç me emër djalin, o Arif... Asllan e ke... Të hedhur, punëtor. Flori i ka duart, për shpirt të babagjyshit, flori.

SELIMEJA — Flori, flori.

ADILI — Po të mendohemi.

SELIMEJA — Të mendohemi.

ARIFI — (Ngrihet.) Mirë atëherë... Na daltë mbarë. Mendohuni dhe më thoni.

SELIMEJA — Patjetër, patjetër!  
Do të të themi! Posi... Natën e mirë! Të fala nga shtëpia! (Arifi del.)

SELIMEJA — E ç'do t'i thuash? Po, do t'i thuash... A gjen më mirë?... Fat i madh!.

ADILI — Pse jo, thua? S'kemi ç'të pyesim... E njohim... Ja, na është rritur para syve... T'i themi çupës... Mojl!... Po akoma nuk erdhi ajo?... Mos i ka prishur mendjen ndonjë pulisht kësaj?

SELIMEJA — Jo, ç'thua?!... Bah... Adil...

ADILI — S'kam pikasur gjë, pa për shpirt të bagjyshit ia shkul mishin nga eshtrat.

SELIMEJA — Adil! Si ta nxë goja!

ADILI — Kështu të them... Nuk duroj dot unë.

SELIMEJA — Opo, hajt të vendosim dhe t'ia japim Gjergjit... Shpëtojmë nga telashet. E heqim nga qafa jonë...

ADILI — Po vjen më duket.

SELIMEJA — Qetësohu e llafosu urtë e butë.

ADILI — Mirë, mirë! (*Hyn Lirika.*)

LIRIKA — Mirëmbërëma!...

ADILI — I mbaruat ato mbledhjet, konferencat...

SELIMEJA — Ulu, xhan i mamasë!...

LIRIKA — Ç'ke kështu, baba?

ADILI — Që sot e tutje lëri mënjanë!... U rrite...  
Je bërë sa një pelë...

LIRIKA — Baba!

ADILI — Dëgjo këtu! Dëgjo... Unë dhe ajo kërcurja atje të rritëm, të ushqyem, të veshëm, të mbathëm, po si i thonë një fjale, u rropatëm për derën e botës... Vjen një kohë, çupa të lë, po pastë mendjen e hairit... Kemi vendosur të të martojmë... Dhe burrin ta kemi gjetur... Mo, ç'ke kështu ti?... U bëre meit.

LIRIKA — Baba!... Mama!... Unë nuk dua t'ju mërzis... Unë... unë duhet t'jua kisha thënë me kohë... S'ma merrte mendja se do të vinte dita kështu... Nuk e prisja këtë... Duhet t'ju kisha lajmëruar, por...

ADILI — Mo! Ç'm'i ke këto dërc-vërc ti, ëh?... Ma thuaj troç! Mos më bridh rrotull e rrotull gardhiqeve...

LIRIKA — Po ja, unë e kam zgjedhur vetë shokun e jetës... (Pauzë.)

ADILI — Vetë shokun e jetës?... Aaa grua!...  
Grua!... Na paska turpëruar!

SELIMEJA — Adil!...

LIRIKA — Baba, ba...

ADILI — Mbylle portën se do t'i shtrohem mirë sonte kësaj.

SELIMEJA — Adil! Qetësohu!

ADILI — Portën moj, se ia tregoj unë kësaj shokës së jetës së atij shokut të jetës. (Del. Që jashtë dëgjohen turfullimat e tij.) Hë!... për shpirt të babagyshit!...

SELIMEJA — Ç'na paske bërë kështu, moj faqezezë...

LIRIKA — S'kam bërë asgjë që të më nxijë faqen, mama... E dua, më do. Do të martohe-mi.

SELIMEJA — Pupu, ç'na gjeti!... Do të të godasë tani ai... Ose do ta zërë ndonjë krizë.

LIRIKA — S'ka pse të më godasë e nuk i trembem... S'e kam turpëruar... Dhe djali që kam zgjedhur është i mrekullueshëm...

SELIMEJA — E cilin ke zgjedhur, moj pikërrënë?...

LIRIKA — Gjergjin e Arifit.

SELIMEJA — Uëeh! Si the? Si the? Gjergjin e Arifit?!

LIRIKA — Po de, ç'pate?

SELIMEJA — (Bëhet e çmendur nga gëzimi.) Adil, Adil!... (Kthehet Adili.)

SELIMEJA — Adil! Shpëtuam!

ADILI — Shpëtuam e pse?

SELIMEJA — Çupa na paska dashuri me Gjergjin e Arifit!

ADILI — E pastaj çfarë shpëtuam?

SELIMEJA — Po dhe ne atë duam t'i japim... Ajo e paska zgjedhur dhe vetë... Aq më mirë. Mendja na paska shkuar të gjithëve menjëherë...

*(Adili rri si i hutuar. Lirika buzëqesh.)*

SELIMEJA — ...Ky bile është një fat i madh... Rrallë ndodhin këto gjëra... Çudi e madhe... Më mirë që e duan njëri-tjetrin.

ADILI — Po si kujton ti, moj mendjelleshtë, se e qetësove Adilin me këtë? Ëh! Për shpirt të babagjyshit, jo! *(Merr zjarr.)* Po ç'rëndësi ka, moj, kur bota do ta marrë vesh se e bija e Adilit e këtij përcit plak, që mban një vandak mustaqe, ka bredhur vijave e luadheve?...

SELIMEJA — Paçka, me të shoqin ka bredhur...

ADILI — Joo! I thonë dashuri kësaj... I thonë turp... Dhe këtë pabesi që më ka bërë unë s'ia duroj dot... Hapu!

LIRIKA — *(Sypatrembur, me një vendosmëri të rrallë për të.)* Prit baba, prit!... Unë nuk jam kafshë që të vësh dorë mbi mua... Të respektoj si baba, po nuk të lejoj deri këtu...

ADILI — Nuk më lejon... Ha ha ha... Dëgjon, more, nuk më lejon... U bërë ti, moj... Oh... *(Vë dorën në zemër.)* Oh... Kriza! *(Shtrihet.)*

*Gratë rendin ta ndihmojnë.*

SELIMEJA — Ngrija kokën... Merr pak ujë... Ja lage këtu... Hap dritaren. E more Adilziu, sa e sflit veten!... Shko, bija e mamasë, shko që kur të vijë në vete të mos të të shohë... Se do t'i prishet prapë gjaku.

LIRIKA — Mama! Më vjen keq... Unë nuk e dija, se po ta dija s'do kisha folur dhe do ta gëzoja babanë kur të pranoja Gjergjin...

SELIMEJA — U bë kjo... Ik në dhomën tjetër tani.

*Lirika del. Adili vjen në vete.*

SELIMEJA — Qetësohu, Adil, qetësohu!

ADILI — *(Me zë të ngjirur e qaraman.)* Ç'të qetësohem? E ku ka qetësi për mua. Një çupë të vetme..., kisha ëndërr ta martoja unë... ajo u martua vetë...

SELIMEJA — Ti e martove, ti.

ADILI — Po kush e ha këtë... Ajo e mori me dashuri... Bobo, i ziu unë, turp! Turp për shpirt të gjyshit, turp!... Oh!... Me dashuri...

## DULJA PUNON ME NORMA KOLEKTIVE

*Nga thellësia e skenës vjen një babaxhan me xhaketë krahëve dhe me zinxhir në dorë.*

E mo, nuk më njihni, apo bëni sikur nuk më njihni! Si? Nuk më njihni? Dakord! E besoj. Siç duket asnjëri nga ju nuk paska kaluar andej nga tabela e nderit e kooperativës sonë. Aty ku vënë ata, të dalluarit, ata që punojnë me metoda të përparuara. Se po të kishit kaluar, me siguri do të më shihnit. Me siguri. Aty më ke mua. Gjithnjë! Eh! Jo në tabelë, mo, jo! Jo, mor jo! Aty, ore, ulur në çimento. Aty rri unë. Kthehem nga fusha e vete ulem. Dëgjoj radion. Kënaqem.

Meqë nuk më njihni, po jua them vetë. Jam Dulja. Punoj në brigadën e Muços dhe jam shumë i kënaqur. E s'do mend ajo. Kam qenë kooperativist i prapambetur unë, ore!... Kurse sot jam... hm... (Me mburrje.) sot jam... Nuk jua them... Do ta shihni vetë... Më përpara nuk e plotësoja dot normën. A i merrja a s'i merrja 70 pikë. Tani



140 pikë! Punojmë me norma kolektive, vëlla. Kjo është metodë, jo llafe. Unë jam i prerë për këtë metodë. E shihja unë: me normë individuale 70 pikë. Një t'u bërë kolektive — 140 pikë!... Hë, ku e kam tani Sheron! Ai, sa qemë individë, me-



rrte 220-230 pikë. Tani që u bashkuam merr dhe ai 140 pikë. Ra... Ha, ha, ha... Ra se nuk është i prerë për këtë metodë. Dhe vetë propozoi. Po si punon, thoni ju? Më shumë se më parë. Vuu! Po unë, si punoj unë? (*Konfidencial.*) More, keni parë ju që s'lodhem dhe aq? (*Qesh.*) Opo, na plasi shpirti... Sheroja sot, Sheroja mot në tabelë të nderit, në aeroplan. Unë në breshkë. Sheroja në aeroplan. Na u bë Sheroja pilot! S'ka më! Tërë brigada në aeroplan! Tërë pilotë. Dhe unë — Dulja.

Ja, i nxorën rezultatet... Ja dhe brigada jonë, e para... Në aeroplan. Hajde, ore, hajde! Opo, sa qenkan mbledhur para tabelës! Le që dhe këtej duket. Ja Vjollca, Fejzija, Sheroja! S'ndahet Sheroja, Du... Jo! Rama, Aliu... Du... jo... (*I shqetësuar.*) More, po unë ku jam? Ku jam unë, ore?! Dulja?!...

Nuk më paskan vënë... A a a, prandaj më tha brigadieri: «Tundu, më tha, se po fshihesh prapa të tjerëve... Po ha në kurriz të shokëve... Po nuk punove, tha, dhe ditën e punës nuk do ta marrësh tamam... Shiko, shiko... E, ore Duleziu, s'dole që nuk dole dot një herë i dalluar... U dogje për një cikë aeroplan... C'duhet bërë, m'or vëllezër, ëh? Punë! Vërtet... vërtet... Kur ishim individë s'kishte gjë, po tani sikur është turp të ndahem nga shokët. Ika... Ika se mos më shohin shokët dhe kush i dëgjon!

*Nis të dalë pa u vënë re. Në të dalë dikush i thërret që pas: «Dule! Po ti, ore! Tërë brigada në aeroplan, po ti ku je?!»*

DULJA — Unë... hm... hm... unë s'jam aty se u hodha me parashutë!!!

## LIPJE SHTOGU

LIPJA  
HASANI  
KOÇOJA

*Koçoja dhe Hasani përgatisin tavolinën. Hyjnë dalin dhe janë vazhdimisht në veprim.*

LIPJA — *(Sheh që po shtrohet tavolina.)* More, ç'po bëhet këtu?

HASANI — Ajo, de!... Sonte është... *(Largohet.)*

LIPJA — *(Koços.)* Koço, ç'po bëhet kështu?

KOÇOJA — Ajo, or de! U la për sonte... *(Largohet.)*

LIPJA — *(Spektatorëve.)* Dini gjë ju cila është «ajo»? Dhe pse u la për sonte? *(Mbledh supet.)* Hasan... Do të flasësh ti?

HASANI — Sonte shtrohet një darkë e thjeshtë...

LIPJA — Po, e thjeshtë...

HASANI — Me rastin e pesëvjetorit të zgjedhjes së shokut Selim si kryetar i kooperativës. (*Largohet.*)

LIPJA — Pesë vjet, eh? Tani më thuaj ti, Koço, kush propozoi, kush merr pjesë dhe kush paguan?

KOÇOJA — Ata që propozuan, ata do të marrin edhe pjesë. Paguan kooperativa. Ja dhe lista e të ftuarve. (*I jep listën e largohet.*)

LIPJA — Dale, Lipe, se as ke propozuar as merr pjesë, po më duket se vetëm do të paguash. (*Lexon.*) Selimi, Qerimi, Vasoja, Koçoja, Hasani, Trifoni, shoku Kseno, shoku Agron. Lipja s'duket gjëkund, mungon... Bukur. Mirë u ka rënë ndër mend... (*Shpërthen.*) Turp të kenë. Paska mbushur Selimi pesë vjet dhe o burra të bëjmë gjym! Punë e madhe se i ka mbushur! Në daç t'i mbushë, në daç t'i zbrasë, mua nuk më duhet!... Unë si anëtar dua që kooperativa të mos ketë humbje... Pasurinë e përbashkët do ta ruajmë si sytë e ballit, jo ta bëjmë rrush e kumbulla... Unë nuk e lejoj këtë!... A e dini ç'do të bëj. Unë do të...

HASANI — (*Kalimthi.*) E Lipe, e gjete emrin?

LIPJA — S'ka Lipe në listë jo, po unë do të...

HASANI — Kërkoje se aty e ke...

LIPJA — Unë do të... do ta lexoj edhe një herë listën!... (*Lexon.*) Selimi, Qerimi, Vasoja, Koçoja, Hasani, Trifoni, Shoku Kseno dhe shoku Agron... (*Shpërthen*) po unë do të bëj namin... zërin në qiell do ta ngre!... Do t'u shkruaj të tëra gazetave dhe revistave... Ku jemi këtu!... Ç'jemi ne, syleshë? Në vend

që të përpiqemi të ngremë vlerën e ditës së punës la e më la, një të mbledhur rast e pa rast, dhe varda rakia e mezeja... Ngrihuni të gjithë dhe të mos e lejojmë këtë shkelje flagrante të interesave të shenjta të kooperativës!... Kush e ngriti kooperativën, ne! Kush duhet ta ruajë, ne! (I bie gjoksit.)

HASANI — (Ngadalë Koços.) Po ai ç'ka që po rreh gjoksin?

KOÇOJA — Ku di unë, ka marrë zjarr... Lipe, qetësohu, a derëzi... A e gjete emrin?

LIPJA — S'kam nevojë ta gjej emrin! Lipja nuk përzihet në festime pa vend që i sjellin humbje kooperativës... ku njerëzit bëhen tapë natën e pesëvjetorit dhe ia këpusin kolektivisht gjumit edhe dy ditët e para të gjashtëvjetorit se nuk u del rakia.

KOÇOJA — Prit, prit!...

LIPJA — S'ka prit... Nuk e kanë lënë kot Lipen jashtë, jo... E dinë që Lipja ua përplas në fytyrë!...

HASANI — Ore Lipe, pusho! Na shurðhove veshët... Ktheje listën prapa! (Lipja e kthen.) E pe tani?

LIPJA — (Lexon.) Lipe Shtogu... (Pauzë.) Hm... Në ç'orë fillon?


HASANI — (E përqesh.) Në ç'orë fillon... Në orën 9 fillon... Dër-dër-dër, na e bëre kokën dauille!

KOÇOJA — U qetësove tani?

LIPJA — Aspak... Pse ç'më kujtuat... Apo jam brenda unë dhe ta fle mendjen. Jo, jo, mua s'më shkon mezeja kur mendoj... (Hasani sjell

një pulë të pjekur para Lipës, të cilit i  
ndrisin sytë.)

Kur mëndoj se kjo pulë mund të jetonte  
akoma. Si mund të pi i qetë kur unë e di...  
(Vijnë ca shishe me raki përpara tij) kur  
e di që... Raki Skrapari është kjo?



KOÇOJA — Raki Skrapari, provoje! (Lipja e pro-  
von.)

LIPJA — Ka me bollëk?

KOÇOJA — Plot.

LIPJA — Duhet të kishte më shumë të ftuar...  
Se në fakt ne jemi brenda në listë, po  
s'duhet ta flemë mendjen... Po të tjerët?  
(*Pi prapë.*) O, po në fund të fundit tërë  
kooperativa nuk vjen dot... Drejt e kanë  
menduar shokët... (*Pi, këput dhe një copë  
mish.*) Mirë i keni pjekur shokë, i mbushi  
pesë vjet Selimi që u zgjodh?... Bah, si ikin  
vitet!... Mirë është menduar, Selimi shoku  
ynë është... Ç'do të kujtojmë në këtë botë...  
Shpenzime ka... E po në fund të fundit  
jemi kooperativë e pasur. Na lumtë! E po  
s'u bë kiameti për ca qengja e për ca pula  
de.

HASANI — (*Sapo hyn.*) Ngrehuni, shokë, e mbli-  
dhni këto! Darka anulohet.

LIPJA — (*Me dorën në meze.*) Pse?

HASANI — Këtë festë deshëm ta bënim për nder  
të Selimit dhe menduam që atij t'i vinte e  
papritur, që të gëzohej, por ai e mori vesh.

LIPJA. KOÇOJA — Mos! Dhe pastaj?

HASANI — U nxeh, zuri të bërtiste. E anuloi  
festën dhe mishrat na i bëri ngarkim.

(*Lipja fshehurazi bën të dalë.*)

KOÇOJA — Lipe! Prit! Këto kush do t'i paguajë?

LIPJA — Ju... Lipja është prapa listës.

## PROFESIONI YNË, SA I BUKUR!...

BIRÇJA — elektrikist i vjetër  
LEKSI — djalë i ri, elektrikist dhe ai  
ANDONI — sekretar i organizatës së partisë

*Në repartin elektrik. Usta Birçja punon dhe herë pas here i shqetësuar shikon nga Leksi, i cili gjithashtu po punon, po jo shumë i përqëndruar.*

BIRÇJA — Si do t'ia bëj unë këtij djali, more vëllezër?! Gjëkundë nuk ngulet në profesion!... Ia mësove një gjë — mirë! Nuk ia mësove — prapë mirë! Nuk e prish terezinë... Ja, ja, shiko! Po fishkëllen! Po me kaçavidë ç'po bën? (Leksit.) Leksi!

LEKSI — Urdhëro, usta Birçe!

BIRÇJA — Ç'e ke atë që ke zënë?



LEKSI — Një këngë nga festivali, usta, «Anës e pas anës...».

BIRÇJA — Nuk... nuk po të pyes për këngën mor... mor bilbil i Birçes... ç'po bën me atë kaçavidë?

LEKSI — Ehë... Thashë se... Ja, kam hapur një ashtu... Si i thoni ju... zbërtheva një ashtu... bobinë!

BIRÇJA — Thashë mos zbërtheve ndonjë hidrocen-tral... (*Spektatorëve.*) Kalon dreka e një e dy te dollapi shkon... Shikon sahatin... Ja, e hapi... (*Leksi çel dollapin.*) Si do të lidhet me punën ky njeri? Si do ta dashurojë profesionin. Profesionin ynë, sa i bukur! Ne në kohën tonë mezi ia vodhëm ustait. Ia vodhëm se nuk donte të na e mësonte. Kurse sot Partia ka hapur shkolla e kurse. U ka sjellë mjete e aparate. Eh, si do t'ia bëj unë këtij djali! Pa ta pyes për voltazhin se mos na bëjë ndonjë proçkë! (*Leksit.*) Leksi!

LEKSI — Urdhëro, usta Birçe.

BIRÇJA — Sa ishte?

LEKSI — Tre pa njëzet e pesë, usta.

BIRÇJA — Nuk të pyes për orën, moj flutur e Birçes, po për voltazhin.

LEKSI — Aha... 210 volt usta.

BIRÇJA — Ja, tani po shikon vajzat nga dritarja. E harroi punën. E ka dhe moshën, xhanëm. Në moshën e tij neve s'na linin hallet... Ja, e humbi... Me këto mend këtë o e zë dashuria, o e zë korenti. Pthtu!... se s'vjen gjë nga goja... Në korent s'e lë unë se harram buka pastaj... Po nga dashuria s'kam ç'i bëj... Le po ta zërë ndonjë dashuri trifazore. U

pupu... Po dashurinë për punën si do t'ia fus  
këtij njeriu unë?! Edhe sekretari i partisë kaq  
herë më ka folur për këtë... Edhe ai është i  
shqetësuar... (*Kujtohet.*) E di ç'do të bëj? Do  
të bëj atë që më bënte ustai. Kur kishte  
ndonjë punë të zgjedhur të zanatit ma fshih-  
te me kurriz ose më nxirrte përjashta. Mua —  
fap! — më hynte krimbi. Desha zanat unë.  
Ja, po mundohem t'ia fsheh edhe unë këtë  
aparatin këtij. (*E luan haptazi fshehjen me  
kurriz. Leksi nuk e çan kokën hiç.*) Nuk do  
t'ia dijë. Hej bela. (*Befas Leksit.*) Leksi! Bëj  
zahmet e dil pak jashtë se kam një aparat  
të koklavitur për të hapur e dua të jem ve-  
tëm.

LEKSI — Të dal përjashta unë?

BIRÇJA — Ti po kush? (*Spektatorëve.*) Po i zgjo-  
het dëshira për nder.

LEKSI — Për një çikë apo?

BIRÇJA — (*Me vete.*) Prite kur të kundërshtojë.  
(*Leksit.*) Jo, jo, për shumë kohë. (*Spektato-  
rëve.*) Hop! Do të kundërshtojë por i vjen  
zor. (*Leksit.*) Përse mendohesh, ëh? S'je da-  
kord zotrote?

LEKSI — Jo, po mendohem të marr dhe rrobat se  
po vete ora e po iki fare! (*Niset.*)

BIRÇJA — Eeeej! Dale, more, dale eeeej! Prit, o  
xhan, prit se do ta hap përpara syve të tu.  
(*Zë kokën me duar.*) Si do t'ia bëj unë këtij.  
Hej drej! S'ka faj ky. Ky ishte marifet nga  
ata të kohës së Babaqemos. O Leksi!

LEKSI — Urdhëro, usta!

BIRÇJA — Do të flasim njëherë si burrat në të dy?

LEKSI — Flasim, usta!

BIRÇJA — Unë po plakem. Do të dal në pension.  
Ti do të mbetesh këtu.

LEKSI — Unë?!

BIRÇJA — E ti. Ja do të kesh uzinën në dorë. Ta ha syri? E bën dot ti këtë punë pa mua mbi kokë?

*Leksi s'flet. Hyn Andoni.*

ANDONI — E, usta Birçe, si i ke punët? Si je Leksi!

*Takohen.*

BIRÇJA — Hë, mo sekretar, kur erdhe nga seminari?

ANDONI — Ja tani. Mbrëmë ju kishin marrë nga shtëpia natën?

BIRÇJA — Më kishte zënë një gjumë, or ti. Ishte ora një e gjysmë.

ANDONI — Më thanë, më thanë. Avari, ëh? E ndreqët shpejt?

BIRÇJA — Prodhimi pothuaj nuk reshti fare.

ANDONI — Atë mendova. Janë mbjelljet!

BIRÇJA — Pse unë nuk e dija?! Mbillet gruri, buka.

ANDONI — Ju lumtë! Ju lumtë! Duket kështu si pa rëndësi kjo puna juaj, por pà shiko. Trima jeni, të palodhur jeni. Mbrëmë pa gjumë, sot në punë... Do t'ju mbaj dhe unë ndonjë gjysmë ore, jashtë orarit... Një defekt i vogël.

BIRÇJA — Mos e diskuto.

ANDONI — Veç mos i flihet Leksit... Hë, Leksi, e prishe gjumin mbrëmë?

BIRÇJA — (*Javash.*) Laksin s'e morëm.



ANDONI — Pse?

BIRÇJA — Nuk deshëm ta zgjonim. Mbase s'kishte qejf.

ANDONI — Ku e di ti?! E pyete? Ia shpjegove?

BIRÇJA — Jo, thashë se...

ANDONI — E prishe, usta Birçel... Dhe ankohesh se s'po i fut dot në gjak zanatin... S'mësohet profesioni larg halleve të uzinës. Po i fole për bukën...

BIRÇJA — Për bukën i flas unë... se zanati...

ANDONI — Jo për bukën e tij, ore, jo... Për bukën e të gjithëve. Ashtu e kupton më mirë ai... Ah, Birçe! (*Duke dalë.*) Të pres. (*Del.*)

BIRÇJA — (*Pas një pauze.*) Pse nuk zhvishesh, Leks?

LEKSI — Po usta Andoni foli për një defekt.

BIRÇJA — Orari mbaroi.

LEKSI — Mbase e rregullojmë shpejt... Ore usta, pse nga unë do të presin kur ti të dalësh në pension, ëh?

BIRÇJA — Nga ti, po nga kush!

LEKSI — Mua do të më ngrenë natën?

BIRÇJA — Ty.

LEKSI — Dhe uzina do të presë nga unë?

BIRÇJA — Posi!

LEKSI — Demek po nuk prodhoi uzina, buka...

BIRÇJA — Tani e more vesh ti!

LEKSI — Po ti tani ma the!

BIRÇJA — Tani ta thashë, o bir, tani... Ama këtu e paske çelësin ti, o trim?! Drejt e ka sekretari... Jo bukën e tij, ore kujtoi bukën e të gjithëve... Këtu e paske çelësin ti... Ta hap zemrën ustai ty! Shtrak. Eja me mua.

## MASAT E RAKOS

RAKOJA — shefi i sigurimit teknik

LIRIKA — punëtore

AGRONI — punëtor

CANI — punëtor

*Agroni, Lirika dhe Cani po punojnë në instalimet elektrike.*

*Hyn Rakoja i ngarkuar me tabela.*

RAKOJA — Më vjen shumë keq, domethënë, që punonjës të pararojës si ju, punonjës që nuk kursehen kur e do muna, siç është rasti...

AGRONI — Hë, more shoku Rako, ku do të dalësh?

RAKOJA — Prit, prit, më vjen keq që shokë të pjekur, domethënë me shkollë të kryer pa shkëputje, të më këputin mua një fletërrufe për sigurimin teknik, fletërrufe që krijoi kon-

tradikta midis meje dhe drejtorit, kontradikta joantagoniste sigurisht, por prapëseprapë të ashpra...

AGRONI — Është problem, shoku Rako, pse e nënvleftëson.

RAKOJA — Nuk e nënvleftësoj, e mohoj fare. S'e kemi problem.

CANI — Shoku Rako, ne presim një kuptim të drejtë të problemit nga ana jote dhe masa të menjëhershme, kurse ti...

LIRIKA — Urdhëro!... I sheh këto prizat që janë të zbuluara... Po të të zënë...

RAKOJA — Po pse, moj e uruar, kush të thotë të vesh të futësh duart në prizë.

LIRIKA — E po, helbete, gjatë punës... Këto duan kapakë...

RAKOJA — Kujdes duan, kryesisht kujdes... Tani, domethënë, dhe kapakë duan, po ata duhen tërhequr me urdhër xhirimi e tjera e tjera... Telashe! Kurse njeriu e lë kot në gjumë kujdesin e tij... Zgjojeni! Ja një tabelë. (*Vendos një tabelë*)... Dhe një tjetër (*Vendos tjetrën*). Ja dhe një. (*Vendos tabela*)... More shokë, more vëllezër, kryesorja është që të edukohemi me ndjenjën e vazhdueshme të kujdesit.

AGRONI — Ore shoku Rako, do të punojmë ne apo do të rrimë të lexojmë tabelat?

RAKOJA — Dhe nunë dhe lexim... Pa shkëputje nga puna.

LIRIKA — Ohu...

RAKOJA — Unë e di që ju do t'i nënvleftësoni, do t'i harroni prandaj... e parashikova. (*Vendos një tabelë tjetër ku është shkruar: «Lexoni tabelat».*)

CANI — E sa para bëjnë tabelat, more shoku Rako... A e di ku është shoku ynë Sifi? Me raport... me të ftohur... Mungesa e tij na dëmton punën. Dhe pse? Sepse ti nuk tundesh të na sigurosh dy xhama, por na lë fresko-fresko tërë repartin. Vë tabela ti!...

RAKOJA — Ma vërteton dot ti mua se Sifi e mori të ftohurën këtu? Ma vërteton?

CANI — Po si të them?... Ka shumë të ngjarë.

RAKOJA — Po ç'të ngjarë, more shokë, ç'të ngjarë!... Mos do të vijë Rakoja t'ju shikojë kur zbuloheni natën nëpër krevate?! Pse nuk u sëmure ti për shembull, por ai?

CANI — Dhe unë me rrufë jam.

RAKOJA — Qofsh shëndoshë! Si kujton, se Rakoja do të përgjigjet për të gjitha të ftohurat, rrufat, të teshtiturat dhe të psherëtiturat tua-ja?... Këto ngrini ju në fletërrufe? E le, po doni përgjigje me vepra e me shkrim... (E zë korenti. I inatosur shkund dorën dhe vendos një tabelë: «Kujdesi të vijë në rritje!») Më ankoheni dhe për banesën me punë vullnetare që kemi këtu.

AGRONI — Skeleritë janë të pasiguruara... Dërrasat janë të shtrembra, të rralla dhe të pambërthya.

RAKOJA — Dhe për ato i kam marrë masat. Ja tabelat! (Del nga skena.)

AGRONI — (Me tallje.) U ke bërë dhe atyre tabela? E po, shpëtuan dhe ata të shkretë se ishin në rrezik...

CANI — T'i vendosë Rakoja, të jetë në rregull.

LIRIKA — Kujdes, shoku Rako!

AGRONI — Ka tabelat Rakoja, nuk e gjen gjë.



CANI — Opo të ruhet se tabela nuk është para-  
shutë. Do të bjerë shakull se po ecën ser-  
bes.

RAKOJA — (Nga lart.) Dhe një këtu... Opaaa... Of!  
ATA — Ç'pate?

RAKOJA — Of, më hyri një gozhdë... Uf!... Më  
kujtoni poshtë të porositim një tabelë kundër  
gozhdëve... Aj, aj... Keni jod?

CANI — Ti s'na ke sjellë e s'ia kemi parë bojën,  
ka nja katër a pesë vjet...

*Nga lartësia e skenës bien tabelat dhe  
pas tyre Rakoja që mbetet i varur, pas  
një dërrase.*

ATA — A a... Rako!

RAKOJA — Ndhimë... Oo, rashë!...

LIRIKA — E zeza! Ndhimojeni. Kujdes!

AGRONI — Për fat dërrasa është e lidhur mirë.

CANI — Ka dhe ganxhën në pallto.

LIRIKA — Cani, vrapo në telefon, të vijë vingi.

RAKOJA — Keni një litar?

AGRONI — Jo.

RAKOJA — Po batanije?

AGRONI — Jo.

RAKOJA — Po çarçaf?

AGRONI — As çarçaf as jorgan.

RAKOJA — Po si do t'ia bëj? Unë mezi po mba-  
hem... Po më lënë forcat. Sa vajti ora?

LIRIKA — Dy.

AGRONI — Të mbaroi dhe orari zyrtar.

RAKOJA — Kush po pyet për orar zyrtar... Po rri  
ca dhe jashtë orarit... Kam hall... Kam hall se  
do të kalojë drejtori e do të më shohë kë-  
shtu për turp!

*Kthehet Cani.*

CANI — *Po vjen. Telefonova menjëherë.*

RAKOJA — A a a a! Shokë, një dërrasë sipër kokës time... (*Gati duke qarë.*) Me një fije gozhdë mbahet.

AGRONI — (*Duke mbajtur të qeshurën.*) Durim edhe pak, Rako... Nuk është dërrasë, është tabelë.

RAKOJA — Opo të vdesësh nga tabelat që i ke bërë me duart e tua... Po shpëtova... Po shpëtova!...

AGRONI — Do t'i harvosh këto peripeci.

RAKOJA — Jo, ju betohem... Publikisht... Ja, kenilaps?

AGRONI — Po.

RAKOJA — Shkruani, t'ju diktoj. Përgjigje fletërrufesë.

AGRONI — Jo, jo se duket sikur po e shkruan nga zori.

RAKOJA — Jo, shokë... Singerisht, shokë, singerisht... Me ç'po heq e me ç'po shoh... Unë Rako Billa i ndodhur as në qiell as në tokë e kuptoj mirë, oh rashë, e kuptoj shumë mirë. Oooo!...

AGRONI — (*Duke shkruar.*) Oooo!

RAKOJA — Po mos shkruaj Ooo, more!... Mua më ra këpuca. Po bie ca nga ca.

CANI — Mibaju Rako se po vjen, vinçi!

RAKOJA — Po më lënë forcat... E kuptoj shumë, shumë mirë nevojën e sigurimit teknik, nevojën e kujdesit për shëndetin e punonjësve, do të marr masa konkrete.

*Shoku i jep shenjë vinçit ta ngrejë.*

RAKOJA — (*Duke u zhdukur në lartësi, vazhdon të diktojë.*) Shkruaj, do të marr masa... do të marr masa... do të marr masa. Uf plasa!

## KOMISIONI DORELESHUAR

AGIMI  
GAZETARI  
KRYETARI I KOMISIONIT TË KATEGO-  
RIZIMIT  
ANËTARI I PARË  
ANËTARI I DYTË  
PUNËTORE QË KATEGORIZOHEN

**Pamja e parë.**

*Në një korridor të administratës.*

*Hyjnë Agimi dhe gazetari.*

AGIMI — E po, ç'është e mirë të solli? Punë në prodhim, do të shkruash ndonjë reportazh, apo?...

GAZETARI — Jo, jo. Jam ngarkuar të bëj verifikimin e një letre.

AGIMI — Çfarë letre?

GAZETARI — Një punëtor juaji ka shkruar një

letër, me të cilën kritikon komisionin e kategorizimit në ndërmarrje. Desha të verifikoja para se ta botonim... Ja, p.sh., Agim, fillojmë me ty: ç'mendim ke?

AGIMI — Mos më pyet fare... Paske fat... Komisioni është mbledhur pikërisht sot... Eja, të të shpie unë... Këtej... (Dalin.)

### Pamja e dytë.

PUNËTORI I — Të hyjmë ne të tjerët?

KRYETARI — Prisni dhe një minutë, he baba-xhan?

ANËTARI II — Kemi një mbledhje të shkurtër... fare, fare të shkurtër.

### Punëtori I del

ANËTARI I — Mua nuk më duket e drejtë që komisioni të mblidhet në ditë të tilla si kjo e sotnja!

ANËTARI II — Ndeshja ndërkombëtare është në kulmin e saj kurse ne rrimë këtu të mbyllur me bullona e rrota e spina. Apo nuk kam edhe një dhembje koke!

ANËTARI I — Propozoj: Mbledhjet e komisionit të planifikohen duke pasur parasysh gjithmonë kalendarin ndërkombëtar.

ANËTARI II — Dhe atë kombëtar.

KRYETARI — Dakord... Kurse për sot unë hedh poshtë propozimin që provat e kategorizimit t'i pezullojmë... Unë them t'i vazhdojmë por

me ritëm pak më të shpejtë. Pyetje tak-  
-fap dhe hajt, apo jo, mor babaxhan?

ANËTARI I — Eo. Të paktën të shohim lojën e dytë!

KRYETARI — Të paktën të shohim lojën e dytë!

ANËTARI I — Ore, duhet të kemi parasysh se nje-  
rëzit këtu nuk vijnë kot. Janë përgatitur.

ANËTARI II — More, edhe pse më dhemb koka,  
besimin tek masat e gjera unë nuk e humb...

Aty për aty nuk e di. Do ta mësojë!

KRYETARI — Ama jo.... Po nuk e mësoi, turp të  
ketë! Vazhdojmë!

ANËTARI I — Vazhdojmë!

ANËTARI II — Vazhdojmë!

KRYETARI — Tjetri!

ANËTARI I — Tjetri!

ANËTARI II — Tjetri!

### *Hyn punëtori I*

KRYETARI — Hë, mo babaxhan, je përgatitur?

PUNËTORI I — Çka. Unë jam përpjekur....

ANËTARI II — Bjeri shkurt të lutem, po apo jo?

PUNËTORI I — Po.

ANËTARI II — Emrin?

PUNËTORI I — Aqif Dudushi.

KRYETARI — Kush ka pyetje?

ANËTARI I — Unë. *(I afrohet punëtorit, i vjen  
rrotull dhe duke e shikuar drejt në sy, e  
pyet) Sa me sa janë?*

PUNËTORI I — *(Ngadalë.)* Kush?

ANËTARI I — *(Po ashtu.)* Ata... në ndeshje.

PUNËTORI I — *(Po ashtu.)* Një me zero për tanët.

ANËTARI I — S'kam më pyetje. *(Duke fërkuar  
duart.)* Jam shumë i kënaqur!...

KRYETARI — Ka pyetje ndonjë shok tjetër?

ANËTARI II — Unë.

KRYETARI — Hajt, babaxhan, tundu.

ANËTARI II — Sa lloj filetosh kemi? Si mprehen thikat në lëng? Si e shpjegon thyeshmërinë e gizës? Na fol gjerë mbi historinë e zhvillimit të makinave metalprerëse. Dhe pas-taj do më përgjigjesh shkurt në këto pyetje: Ç'është mikrometri? Si llogaritet toleranca dhe e fundit: mos të ndodhet ndonjë aspirinë, se mbarova nga koka?

KRYETARI — Oooooo!!!

*Anëtarët hahen kokë më kokë për volumin e madh të pyetjeve, por kohën që po ikën dhe pyetjedhënësi ankohet për dhimbjen e kokës.*

PUNËTORI I — Ne të gjithë e dimë...

KRYETARI — Mirë, babaxhan... Kalo në pyetjen e fundit.

PUNËTORI I — Aspirinë, Aspirina... Jo, nuk kam.

ANËTARI II — Je i sigurt?

PUNËTORI I — Po.

KRYETARI — (Anëtarit.) Ke gjë tjetër?

ANËTARI II — Jo, jo, mjafton... Mund të ishte përgatitur më mirë.

KRYETARI — Unë kam një pyetje pak të vështirë... Por ama, babaxhan, dua të më përgjigjesh shkurt dhe mos më gënje se unë të nuhas menjëherë. Jemi burra, dreqi ta marrë!... More babaxhan, i di ti llojet e limave apo s'i di... Të drejtën ama...

PUNËTORI — Cilat?

KRYETARI — Llojet e limave.

*Pauzë*

PUNËTORI I — I di.

KRYETARI — Bravo të qoftë. (*I shtrëngon dorën.*)

Dil tani dhe na thirr tjetrin.

ANËTARI I — Shoku kryetar. Mendoj t'i thërresim të gjithë bashkë.

KRYETARI — Të gjithë. (*Te dera.*) Ejani të gjithë.

*Hyjnë djem dhe vajza*

KRYETARI — Qetësi. Doni t'ju pyesim veç e veç apo të gjithë bashkë?

ATA — Bashkë, bashkë!

ANËTARI II — (*Pasi i hedh një sy sahatit.*) Si quhet aparati që mat diametrat nga brenda?

ATA — Komperator!

ANËTARI II — Çfarë do të quajmë kalesë?

ATA — (*Në kor të ngatëruar thonë këto fjalë.*)  
Thellësi të kalesës do të quajmë diferencën midis diametrit të vjetër dhe diametrit të ri që del pas tornimit, pjesëtuar për dy.

KRYETARI — Si, si?

ATA — (*Përsërisin koralen.*)

KRYETARI — Ndonjë tjetër ka pyetje?

ANËTARI I — (*I bërë gati për të dalë.*) Unë jo.

KRYETARI — Kam unë. Shkurt. Si burrat. Më thoni vetëtimthi: I njihni skicat?

ATA — Po.

KRYETARI — Teknikën e sigurimit?

ATA — Po.

KRYETARI — Respektoni orarin?

ATA — Po.

KRYETARI — Higjienën, rregullin, disiplinën?


ATA — Po, po, po.

KRYETARI — Ditën e mirë, babaxhanë! Mirupafshim në stadium!

*Ata dalin.*

ANËTARI I — Ikim?  
 ANËTARI II — Mos!  
 KRYETARI — Ç'pate?  
 ANËTARI II — Paskemi dhe një tjetër!  
 ANËTARI I — Hej bela! Fute shpejt!  
 KRYETARI — Fute!  
 ANËTARI II — (*Gazetarit.*) fute.  
 GAZETARI — (*Duke hyrë.*) Si fute?  
 ANËTARI II — Desha të them: futu, Shpejt!  
 GAZETARI — Ju jeni anëtarët e kom...  
 ANËTARI II — Pyetjet i bëjmë ne.  
 KRYETARI — Emrin?  
 GAZETARI — Shiko unë nuk jam...  
 KOMISIONI — O po mos e zgjat!... Emrin!  
 GAZETARI — Ortek Mali!  
 ANËTARI I — Shoku Tek më thuaj filetot.  
 ANËTARI II — Veglat matëse.  
 KRYETARI — Veglat shpuse.  
 GAZETARI — Shikoni shokë...  
 KOMISIONI — I di?  
 GAZETARI — Unë erdha...  
 KOMISIONI — O po i di?  
 GAZETARI — Jo, nuk i di.  
 ANËTARI I — Më pëlqejnë njerëzit e singertë.  
 KRYETARI — Nëma dorën, babaxhan! Thuaj të drejtën, do t'i mësosh? Hajd, jepi fjalën komisionit.  
 GAZETARI — Patjetër... E dini si është puna?  
 ANËTARI II — Shshsht! Ti pusho! Flasim ne.  
 Llojet e tornove, cilat janë?  
 GAZETARI — Nuk i di.  
 KRYETARI — Këtë s'e di, atë s'e di. Por çfarë di ti, mor babaxhan, që të të pyesim?  
 GAZETARI — Asgjë.





KRYETARI — Hiç?

GAZETARI — Or po hiç fare.

ANËTARI I — Tapë?

GAZETARI — Tapë topi... E di si është puna...

Ju s'po më lini të sqarohem.

KRYETARI — Një minutë të lutem.

*Komisioni mblidhet kokë më kokë.*

KRYETARI — Shiko, or ti... Si e kishte emrin ky, more?

ANËTARI II — *(Duke hapur bllokun.)* Çift më duket.

ANËTARI I — Jo, jo, tek.

KRYETARI — *(Lexon.)* Hm, po. Shiko ti, Ortek.

Komisioni vendosi të të ngrejë një kategori më lart për këto arsye:

a) Na dukesh burrë i mirë.

b) Je shumë i sigurtë.

c) Për guximin që tregove. Edhe duke qenë tapë topi nuk bëre bisht, por i dole komisionit ballë për ballë. Merre kategorinë. Suksese! Dhe na jep fjalën se do të mësosh që ta meritosh kategorinë që të lëshuam... paradhënie.

ANËTARI I — Paradhënie.

ANËTARI II — Paradhënie.

GAZETARI — Po unë nuk dua kategori.

ANËTARI II — Pse eee?

GAZETARI — Unë s'punoj këtu... Kam zanat tjetër.

KRYETARI — Ore babaxhan, kush je ti?

GAZETARI — Vij nga revista «Hosteni»... Ditën e mirë!

*Komisioni mbetet i ngurrosur* —

## MANOVRIMET E POLIKRONIT

POLIKRONI — shef furnizimi  
PRANVERA — e shoqja  
XHA JONUZI — i vjehrri

*Në shtëpinë e Polikronit.*

POLIKRONI — Më fal, o vjehërr, se mbrëmë erdha vonë dhe nuk të kënaqa!... Ishim me drejtorin dhe me nja dy kolegë në një zifafet.

XHA JONUZI — Po me drejtorin e paske mirë?

POLIKRONI — Grurë. Me shefin e planit grurë, me llogarinë grurë, me kolegët grurë...

XHA JONUZI — Qenkan drithëra të mbara sivjet...

POLIKRONI — Epo, një shef furnizimi ka ndërmarrrja... Polikron Kokën. Kudo që të vete unë magazinat hapen vetë...

XHA JONUZI — Hajde dhëndër, hajde!

**POLIKRONI** — Polikron Kokën s'e ka njeri! Shkojnë e vijnë drejtorët. Ja, nga Tirana, nga Shkodra, nga Korça, nga Rrogozhina... Kërkojnë të më marrin, por s'më lë drejtori im... Më ka as...  
Hidhet asi:

**XHA JONUZI** — Shiko, shiko!

**PRANVERA** — S'ka si Polikroni... Të tërë e lavdërojnë.

**POLIKRONI** — Të vish në magazinën time, qu-mësht dallëndysheje gjen... Manovroj. Ngri-je, vjehërr!... Gëzuar! (*Pinë.*)

**XHA JONUZI** — Po hë, o dhëndër, si ia bën?

**POLIKRONI** — Në këtë punë duhet hundë... Nu-hatje... Ne jemi ndërmarrje industriale, po në magazinë thua se kemi vetëm bullona e pistonat?... Jo... Këto po se po, por kemi të tjera gjëra. Materiale importi duke filluar që nga vegla rroje të jashtme, termus, lavatriçe, limatriçe, stokatriçe, perforatriçe.

**XHA JONUZI** — Vërtet?!

**POLIKRONI** — Po, magnetofona, gramafona, shabllona deri dhe bibirona.

**XHA JONUZI** — Ou, ou për vete?

**POLIKRONI** — Jo, jo për të tjerët, manovron Polikroni, manovron.

**XHA JONUZI** — Po si jua japin?

**POLIKRONI** — ...Planifikoni, — thonë, — çfarë doni nga importi, nga jashtë... Dhe ne duam atë e këtë, të gjitha... dhe na vijnë.

**XHA JONUZI** — Dhe ju vijnë ... Po tani s'kuptoju pse ju duhen të gjitha këto që s'ju duhen?

**POLIKRONI** — Manovron Polikroni...

**PRANVERA** — Manovron Polikroni, manovron.

**POLIKRONI** — Gjatë vitit, p.sh., më lipset për

nevojat e ndërmarrjes hekur. Hekur s'kam. Të ishte ndonjë tjetër do ta humbiste to-ruan... Po Polikron Koka, jo! Marr çantën dhe u vete atyre që kanë hekur e u them... Kam dyqind kuzhineta suedeze, më jep hekur? Të jap, thotë ai... Na... nëm... Na duhet një elektromotor... S'kam në magazinë. Po kam limatriçe që s'më duhet... Fiuuu, një xhiro me gaz... Më jep, të të jap... Dhe kështu gjatë vitit dua izolant, jap heksaklorant, dua testato, jap bronz me tonelata.

XHA JONUZI — Qenke kokë e madhe, Polikron! Unë s'ia them nga këto punë, po me këtë radaken time besoj se po të më duheshin gjatë vitit bullona, do të kërkoja nga jashtë bullona e jo makarona, më duhen lavatriçe, marr lavatriçe e jo salsiçe, verniçe e mastiçe.

POLIKRONI — Të paska qejfi salsiçet më duket?

XHA JONUZI — Po ju kështu e bëni, çorbë! Se shteti ju beson. Ju jep paratë... Naa... Ju e bëni çorbë me pehlivanllëqe. Se shteti, si shtëpia, ka ekonomi.

POLIKRONI — Po është ca e vështirë të planifikosh tamam.

XHA JONUZI — Pse qenka e vështirë?! Përse ju jep shteti rrogën?

POLIKRONI — Shiko, o vjehërr, ti nuk e kupton. Ato kapital janë.

XHA JONUZI — Si, more, s'kuptuakam... Sallatën tënde e merr vesh dhe një kalama. Ju dëmtoni ekonominë e shtetit.

POLIKRONI — Më vjen keq. Se mos po vjedh... Mos po lodhem për shtëpinë time... Dhe ne punën e shtetit bëjmë.

XHA JONUZI — E bëni si karavidhja.

POLIKRONI — Më vjen keq... Po punojmë natë e ditë.

XHA JONUZI — Si qorrat.

POLIKRONI — S'po marrim frymë... E kemi harruar fare shtëpinë. Ja unë alamet shef furnizimi... ka një vit që i kam mbledhur paratë, sot mezi rregullova për shtëpinë time një frigorifer. Meqenëse ra fjala... Grua... më nxirr një çikë ato paratë.

*Pranverës i bien pjatat nga duart.*

POLIKRONI — Ç'pate?

PRANVERA — Polikron, xhan... s'e marrim dot.

POLIKRONI — Ç'farë, mos ke harxhuar nga ato para?

PRANVERA — Po... Bleva salcë domate me tubeta... Pata rast dhe... Se ato dalin rrallë.

POLIKRONI — Salcë, punë e madhe e sa salcë bleve?

PRANVERA — 337 tubeta.

POLIKRONI — Sa?!

PRANVERA — 337, se ato dalin rrallë.

POLIKRONI — Po pse, moj, jahni për ushtrinë e sultan Muratit do gatuash!

PRANVERA — Jo do të manovroj... Do t'i jap 20 Burbuqes se do të më japë terital, nga ai bezha që u mbarua... Do të manovroj...

XHA JONUZI — Manovro, të keqen babai, manovro dhe ti me burrin.

POLIKRONI — Po të tjerat?

PRANVERA — Të tjerat? Dhjetë tubeta...

POLIKRONI — Moj, po lëri tubetat, paratë e tjera po të them. Sa të kanë mbetur?

PRANVERA — Asnjë.

POLIKRONI — Asnjë?!



PRANVERA — Bleva 40 palë çorape xhami, tri-  
dhjetë potiqe.

POLIKRONI — Potiqe?

PRANVERA — Posi... Ato prapë kapital janë... Se  
unë do të manovroj.

XHA JONUZI — Manovro, të keqen babai... Hajde,  
o Polikron Koka, hajde, vetë aso, gruan aso  
— do t'ju venë punët graso.

## NIQIFORI KUJDESET PËR KOPERTINËN

NIQIFORI  
FERIKU  
MASARI  
LUTFIU

LUTFIU — Na ÷sh njëherë një pulë që u kujtua se duhej të bënte vezë në minutën e fundit. Pula është shoku Niqifor. Niqifori është... Do ta njihni vetë tani... Dhe veza, vetvetiu, është kampionati lokal i futbollit, ku ndërmarrja jonë me meritë u klasifikua në fund, pa asnjë pikë dhe me një qerre me gola të pësuar. Portieri ynë e nxori topin nga rrjeta 37 herë dhe nga këta 18 ishin gola që na i bënë kundërshtarët e 19 gola që i bëmë vetes sonë e që portieri ynë i gjorë s'i pengoi dot. Ishte e vetmja garë ku ua kaluan kundërshtarëve.



Po ajo për të cilën kam dalë këtu është dëshira për t'ju treguar çastet e paharruara të operativitetit të shokut Niqifor, që nuk çau kokën deri ditën e fundit. Befas, dikush në telefon e kishte alarmuar duke i thënë se në kampionat do të asistonin shokë me rëndësi.

Para Niqiforit vijnë mendueshëm Ferriku, Masari dhe Lutfiu.

NIQIFORI — Po ky është kulmi! Dy ditë para kampionatit lokal të futbollit ne nuk kemi marrë asnjë masë! Alamat ndërmarrjeje me... me... emër, me kolektiv luftarak, me drejtor sportdashës... të mos marrë pjesë në këtë sport të fuqishëm emocionant. Ndërmarrja jonë nuk është pa tradita... A nuk jemi ne, që parvjet, mbas një beteje të ashpër, shumë vendin e parë në grupin e ndërmarrjeve që luftonin për vendin e 19 deri tek i 20-i?! Ku do t'i hedhim këto tradita? Në kosh? Flisni. Pse më rrini si të shushatur? Pasnesër në stadium do të ketë edhe shokë nga Ministria.

MASARI — Shokët e Ministrisë nuk do të vijnë.

NIQIFORI — *(Me një fije shprese.)* Ku e di ti?

MASARI — Më thanë.

NIQIFORI — Je i sigurt?

MASARI — Shumë i sigurt.

*Niqifori ulet dhe nxjerr shaminë e lehtësuar.*

LUTFIU — Do të vijnë, more! Ata gjithnjë kanë ardhur.

NIQIFORI — *(Me inat Masarit.)* Do të vijnë. Gjithnjë kanë ardhur ata.

LUTFIU — Pse për ata e bëjmë ne?!

NIQIFORI — Nuk e bëjmë për ata ne! Pa m'u përgjigjni. Pse nuk u sinjalizova me kohë?  
FERIKU — Në fakt... në fakt, shoku Niqifor, ju duhet ta dini, unë ju thashë, po ju s'ma vutë veshin se ishit zënë me prodhimin.



NIQIFORI — S'më duhet prodhimi sot! Dua futbollin, dua skuadrën, nderin sportiv të ndërmarrjes. Fol, Ferik! Ç'duhet të kishim bërë, ç'kemi bërë dhe ç'duhet të bëjmë?  
FERIKU — Duhet të kishim bërë mjaft. S'kemi bërë asgjë dhe duhet t'i bëjmë të gjitha.  
NIQIFORI — Lëri driblimet, Ferik. Fol!

FERIKU — S'kemi uniforma. Para dy javësh unë ju kërkoja... paratë kurse ju...

NIQIFORI — Urgjentisht të lajmërohet llogaria... Të blihet materiali, të qepen... tunduni!

LUTFIU — Na ish njëherë një pulë që i erdhi veza... *(Duke dalë.)* Po shkoj unë në llogari.

NIQIFORI — Pa qëndro pak me atë pulën ti, shoku Luto!

LUTFIU — Unë qëndroj, shoku Niqifor, por pula jo, se i ka ardhur veza. Do të flasim pas kampionatit. *(Del.)*

NIQIFORI — Duro thumbat e Lutos, të lutem shumë! Jo pula, jo veza. Hm! Sikur po zgjidhim problemet e pularisë! Vazhdo, Ferik!

FERIKU — Dërgova furnitorin për këpucët e futbollit.

NIQIFORI — Dhe...

FERIKU — Furnitori u kthye, i solli këpucët, por ato nuk na bëjnë punë.

NIQIFORI — Pse?

FERIKU — Dyqani i artikujve sportivë kishte furnizuar me kohë ndërmarrjet e tjera dhe për ne kishin mbetur një palë këpucë nr. 45...

NIQIFORI — Ehë! Portieri.

FERIKU — Katër palë 44...

NIQIFORI — Katër mbrojtës.

FERIKU — Tre numër 37...

NIQIFORI — Mes fushe.

FERIKU — Dhe tre numër 36...

NIQIFORI — Sulmi. Shumë mirë. Në sulm lojtarët e lehtë me këmbë të vogla, që të manovrojnë në zona të ngushta. Në mes të fushës ata me numër 37, që lëvizin lehtë. Në mbrojtje të fshijnë numrat 44, si lopata. Varianti 1-4-

- 3-3. Me këtë variant, me sa di unë, lozin edhe kampionët e botës! Më sillni skuadrën këtu. Hë, more, ç'më rrini kështu të pikëlluar, pse s'flisni?!
- FERIKU — *(Pa qejf.)* Skuadrës sonë nuk i bëjnë këpucët... Kishim skuadrën, s'kishim këpucët... Tani kemi këpucët...
- NIQIFORI — Po tani si i bëhet?
- FERIKU — I porosita të arnojnë të vjetrat...
- NIQIFORI — Këpucë të arnuara në ndërmarrjen tonë! Nuk lejoj arna unë! Ç'do të thonë pastaj shokët nga Ministria?
- MASARI — *(I përshpërit Ferikut.)* Po më duket se ata nuk do të vijnë.
- FERIKU — Do të vijnë, more, ç'flet ti?
- NIQIFORI — *(Që ka përgjuar bisedën e tyre, me inat.)* Do të vijnë, more, se më hëngre! Këpucët ja ku i keni! Fringo!
- FERIKU — E po edhe unë i gjori s'di si të bëj, o shoku Niqifor. O do luajë skuadra që të mos turpërohemi ne, o do të luajnë këpucët që të mos turpërohesh ti!
- NIQIFORI — Këpucët! Të krijohet skuadër e re, sipas këpucëve! Kështu e bëjmë futbollin të masave... Pse, more, me të njëjtën skuadër do të rrimë ne? A nuk mundim ne të gjejmë një shok këmbëmadh me numër 45 për portier? Katër shokë që u venë këpucët 44 etj. Kolektivi ynë i gjerë u ka bërë gjithnjë ballë vështirësive... Të lozim, shokë, të kërkojmë... Të lajmërohen urgjentisht të vijnë tek unë në zyrë të gjithë anëtarët e kolektivit me numër këmbe 44 e lart dhe 37 e poshtë. Të tjerët të mos shkëputen nga fronti

i prodhimit. (Masarit që ia ka sjellë në majë të hundës me atë punën e Ministrisë.)

Ti sa e ke numrin e këmbës?

MASARI — Dyzet e një.

NIQIFORI — Në punë. (Masari largohet.) Të gjenden këmbë për këpucët e reja që blemë. Do të gjenden se s'bën.

FERIKU — Lind edhe problemi i stërvitjes së tyre, shoku Niqifor.

NIQIFORI — Ajo është puna më e lehtë. Kryesorja është paraqitja... Uniforma e saktë... Paraqitja... Posi! Se për atë na pjell belaja... Një lidhëse të mungojë... do të thonë: ç'ka bërë Niqifori... Ehu, llafe plot dalin... Ama nuk dinë të lozin! E po se mos janë profesionistë! E, mo, se në fund të fundit një penallti dimë të gjuajmë të gjithë. Më shumë besim, Ferik! Dhe dëgjo, porosit të gjithë të gjuajnë në shtyllë. Ajo e huton kundërshtarin... Shtyllë bam... shtyllë bam...

FERIKU — Kundërshtarin?

NIQIFORI — Jo, jo them për shtyllën. (Dalin.)

## PRAGU I SHKOLLËS — KUFIRI I EDUKIMIT

URANI — qytetar  
SELAMI — mësues  
Nxënës të shkollës

*Skena paraqet portën e shkollës. Urani pret te porta i pavendosur. Selami ka mbaruar mësimin dhe po del. Ndërkohë parakalojnë disa nxënës.*

NXËNËSIT — Ditën e mirë, shoku mësues!  
SELAMI — *(Pas tyre.)* Ditën e mirë, ditën e mirë, djema! Nxënësit kalojnë portën dhe ia mbarthin me vrap, ndërsa Selamit i del përballë Urani.

URANI — Shoku mësues, do të më falni po kam ardhur të ankothem... Jam tepër i tronditur... Jam si i shushatur, pothuaj i trullësor.

SELAMI — Urdhëroni, urdhëroni, shoku qytetar,  
flisni!

URANI — Akoma s'po e mbledh veten... Nxënësit  
tuaj më kanë qëlluar në kokë me top... Ja  
kështu!

SELAMI — Me top?

URANI — Po, me top.

SELAMI — Me çfarë topi?

URANI — Si me çfarë topi?! Kur vij ankohem do  
të thotë se nuk qe as top pingpongu as top te-  
nisi, por top futbollit!

SELAMI — Ashtu... Futbollit...

URANI — Si ashtu?! Pse, ç'doni ju të më qëllojnë  
me top kundratank! ...I vogël ju duket topi i  
futbollit?!

SELAMI — Sigurisht. Më i madh është topi i bas-  
ketbollit.

URANI — Ju lutem mos u merrni me këto vogël-  
sira të panevojshme. Në vend që të edu-  
koni nxënësit merreni me kalibrat e topave...  
Ç'bëni ju këtu në shkollë?

SELAMI — Topi fluturoi nga oborri i shkollës dhe  
ra në kokën tuaj?

URANI — Jo, jo unë po kaloja rrugës... Nxënësit  
tuaj po luanin mu në mes të rrugës... Shkel-  
muan topin dhe më goditën... Ja, kështu.

SELAMI — D.m.th. topi nuk ju erdhi nga shkolla?

URANI — Jo. Që këtej nga rruga.

SELAMI — Ditën e mirë! (*Nis të largohet.*)

URANI — Si «Ditën e mirë»?! Nxënësit e tij lozin  
në mes të rrugës ai më thotë «Ditën e mirë»!

SELAMI — Tamam... Shko te prindërit e nxënësve...  
Unë përgjigjem vetëm për sjelljen e tyre në  
shkollë.

URANI — Megjithëse jam i trulllosur po më bëni të qesh... Megjithatë, ja unë isha këtu te porta e shkollës... Kjo ia bën muu!

SELAMI — Mund t'ia bëjë muu, mund t'ia bëjë tru lu lu.. Kjo gjë nuk më takon mua.

URANI — Po kjo është qesharake... Të hash alamet shuti te porta e shkollës, nga nxënësit e shkollës, dhe mësuesi i shkollës ta quan of-sajt!





SELAMI — Unë nuk thashë ofsajt.

URANI — A nuk është njëlloj?

SELAMI — Jo, jo nuk është njëlloj... Dëgjo, mik i shtrenjtë... Detyrat janë të ndara... Se ndryshe punët do të bëheshin llum dhe s'do ta merrte vesh i pari të dytin... Ju jeni në pragun e portës... Ju qëllojnë me top në ko...?

URANI — ...Kokë.

SELAMI — Në kokë. Lind pyetja: Që nga erdhi topi? Po qe se topi shkelmohet nga brenda portës, nërgjegjësinë e mban peda...?

URANI — ...gogu!

SELAMI — Gogu! Pedagogu! Dhe ju mund t'i drejtoheni pedagogut, shkollës. Anasjelltas: Kur topi shkelmohet po nga ai nxënës por nga jashtë, d.m.th. nga rruga dhe ju godet në kokë, mos prisni, por drejtojuni fa... fa...

URANI — Fa... fa... Farmacisë!

SELAMI — Familjes! Familjes së nxënësit. Duhet t'i ndajmë gjërat.

URANI — Po unë po futesha në shkollë.

SELAMI — S'ka rëndësi. Topi u godit nga jashtë. Ju vetë e thatë. Unë do ta ndiqja këtë çështje sikur ju të ishit edhe tutje në mes të rrugës por kur ama?... Kur ta konstatoja se topi ishte shkelmuar nga obo... obo...

URANI — Nga obo?!...

SELAMI — Nga obo... Nga oborri i shkollës!...

URANI — Shiko, shiko sa bukur ia ndani vetes detyrat e edukimit... Po kur topi shkelmohet nga oborri, nga nxënësi juaj dhe rrugës kalon një çift pleqsh...

SELAMI — Kuptoj!

URANI — Topi fluturon parabël e godet kokën e

plakës dhe që andej më godet mua surratit...  
Atëherë ku duhet bërë ankesa?

SELAMI — Ky është një rast i komplikuar... Këtu kemi dy ankesa. Plaka do të ankohet te ne se topi erdhi nga oborri ynë.

URANI — Po unë?

SELAMI — Ju do të ankoheni te plaku se ju qëlloi plaka e tij.

URANI — Pse?

SELAMI — Pse? Sep... Sepse... E patë nga erdhi topi?

URANI — E pashë mirë. Është po ai top. Nxënësi ishte në majë të avllisë.

SELAMI — Brenda apo jashtë?

URANI — As brenda as jashtë, tamam në avlli... E shkëlmoi topin lart në ajër... Atje s'kishte as plaka as pleq... Topi erdhi vertikalisht dhe ju përshëndeti.

SELAMI — Jam i qetë.

URANI — Si?

SELAMI — Jam i trullosur, por i qetë... S'kam asnjë përgjegjësi dhe s'kam as ku të ankohem.

## SONTE DO TË NA GATUAJË VERA!

VERA  
FAHRIA  
ERIFILI

*Apartamenti i një familjeje qytetare. Salloni është i mobiluar thjesht, por mirë. Vera, pakëz nervoze, po mbaron së ngrëni një fetë bukë me gjalpë. Që jashtë vjen Fahria. Duket paksa e preokupuar për vonesën, por megjithatë sjell një notë gazmore me hyrjen e saj.*

FAHRIA — Erdhe nga puna edhe s'më gjete, ëh nuse? U mërzite vetëm?

VERA — Jo nuk jam vetëm. Është edhe... pula e dajës!

FAHRIA — (Duke qeshur.) Atëherë bëme mirë që nuk e therëm edhe sot... Ti prisje që ta gje-

- nje në pjatë, e gjete akoma të gjallë.
- VERA — Mirë që u kujtove të vish. Ora katër.
- FAHRIA — (*Heq pallton.*) U vonova te Violeta... U bëmë tri shoqe... Na mbajti për drekë. Fundja, mendova, dy gra jemi. Bëjmë si bëjmë... Liloja është me shërbim.
- VERA — Në këtë shtëpi nuk është vetëm Liloja, e dashur vjehrrë! Eh, ky kulti i burrit!... Sekush ka vendin e vet e detyrën e vet... Ti ke detyrë të gatuash dhe nuk do të bësh keq t'i rrish mbi kokë!
- FAHRIA — (*Pa e prishur gjakun.*) Nuse! Kontratë nuk kemi bërë se... Asnjeri nuk të ka ndaluar të gatuash edhe ti... Po hesht, bijo, se s'ka lezet. Hëngre një herë njëzë fetë bukë me gjalpë dhe...
- VERA — Njëzë?! Është e pestëza fetë që po ha! Dëgjove? Se isha e uritur, jam e uritur dhe nuk dihet edhe sa fetëza do të ha!...
- FAHRIA — Po gatuaje vetë ndonjë gjë, atëherë... Dollapi — plot... E di ku e kemi dollapin?
- VERA — Ho-pa! Ja, doli ironia! Po ironi di edhe unë! Dhe jo vetëm ironi, por edhe satirë edhe sarkazëm! Do më?
- FAHRIA — Edhe sarlopata të mbeti tani!
- VERA — I the Violetës që nusja s'di të gatuajë, që e pret çdo gjë gati, po?!
- FAHRIA — Pse t'ia them Violetës, moj Vera?! Sos do të më ndihmojë!
- VERA — Moj, moj, moj! Halli i madh të ka zënë! Se qenka zor i madh të vësh mbi furnelë një tenxhere ujë e të plasësh brenda, katër kokla mish, dy grushte kripë e një kavanozë salcë! Ju mbetën sytë te nusja e Violetës,

që ngriset e gdhiet në kuzhinë! Dhe kur del në shëtitje i vjen era qepë të skuqura! Ajo mund të dijë të bëjë çoblek, bollgur e sytliaç, por jam e sigurt se ndonjë libër, fjala vjen «Komedinë Hyjnore», nuk ka zënë me dorë!

FAHRIA — Po s'e pat zënë, le ta zërë.

VERA — E, de, dije se nusja jote t'i thotë njëzet e shtatë vargje me një frymë!

FAHRIA — E di. Dhe tridhjeteshtatë mund t'i thuash ti, nga ajo, hyjnorja, po të kesh ngrënë mirë!

VERA — Po s'do mend!... *(E kap me vonesë, nëntekstin e së vjehrrës.)* Ah, dole tek e ngrëna! Tek e gatuara. Sa e vockël që bëhesh nganjëherë, moj mama! Hall për të gatuar... Dhe unë mund të gatuaj... Dhe unë mund të gatuaj kur të dua.

FAHRIA — Mundesh, pse jo! Mbase ke parë.

VERA — Parë jo, po kam dëgjuar se si gatuajnë!

FAHRIA — E po, hë, de! Ku ta gjej. Kështu do të kem kohë të lexoj edhe unë nganjëherë!

VERA — Pse s'ke lexuar. Unë të kam këshilluar kaq herë të lexosh!

FAHRIA — *(Duke qeshur.)* Letrat e makaronave, tubetat e salcës, kutitë me «Mirlan»...

VERA — Ashtu?! Që sot do të gatuaj unë! Gatimi, gatimi! Ç'po bëni? Presh e pilaf? Sikur po bëni vepra të pavdekshme! Do ta shikojmë gatimin tim! Se na qenka i vështirë! *(Hyn në kuzhinë.)*

FAHRIA — Fajin e kam unë vetë, moj nuse!... Ma ka im bir, Liloja... Po edhe ajo krushka, jot ëmë, që të ka përkëdhelur, nuk ka pak faj!

VERA — (*Duke u rikthyer.*) Çfarë the për mamanë, time? Për mamanë, po të pyes... Ç'the?  
*Hapet dera, hyn Erifili.*

ERIFILI — Sa mirë që ju gjeta! Mirse ju gjeta!

VERA — Uh, mamaja!... Ty të kishim në gojë, me mamanë. (*Fahries me bërryl*). Ëh, mama?!

FAHRIA — Po, po, urdhëro krushkë! Sa mirë bërë që erdhe!

ERIFILI — Erdha një copë herë.

VERA — Jo një copë herë mama, por do të rrish për darkë... Kemi një pulë që na e ka sjellë daja i Lilos nga fshati.

ERIFILI — Jo, jo, nuk rri...

FAHRIA — Për ashtu, hiqe nga mendja, krushkë, se sonte do të na e bëjë darkën Vera.

ERIFILI — Pse është e zonja kjo ime bijë të na e bëjë darkën?

FAHRIA — Pse jo! Ca e kishe mësuar ti e ca e kam mësuar unë!...

ERIFILI — Atëherë po rri.

FAHRIA — Rrofsh! Fillo nuse, se u ngrys!...

VERA — Do të filloj!... Do të filloj... Do të...  
(*Rrëmben thikën e madhe të kuzhinës dhe nisat të dalë.*)

FAHRIA — Nuse! Kuzhina është këtej!

VERA — E di!!... (*Me ironi.*) E di, e dashur mama! Por unë po shkoj të marr qepët! (*Del. Dëgjohet një zhurmë kazanësh dhe legenësh. Kthehet.*)

FAHRIA — A do të të ndihmoj?

VERA — S'ka nevojë, mami! Do t'i bëj të gjitha vetë... Dhe zhveshjen e qepëve dhe rrjepjen e patateve dhe dezinfektimin e orizit... Se mos kanë ndonjë punë të madhe! (*Del.*)

ERIFILI — Trimëresha e mamit! Tër, nuk ia bën syri! Dora s'i ka zënë shumë, po ia pret.

*Vera hyn në kuzhinë duke kënduar.*

ERIFILI — Po ngjisja shkallët dhe m'u bë sikur dëgjova zhurmë... Sikur Sikur... si të them... Sikur grindeshin... Mirëpo që nga vinte... Thashë se mos qe këtu... Eh?

VERA — Mama... Mami...

ERIFILI — Hë, bija e mamit!

VERA — I them mamit tjetër.

FAHRIA — Mua?!

VERA — E fillova... Vura tenxheren dhe i hodha dy kokrra qepë... Po ziejnë...

ERIFILI — Dorëmbra e mamit.

VERA — (*Fahries.*) Kemi kripë?

FAHRIA — Kutinë e bardhë... E ke plot.

VERA — (*Duke nxjerrë kutinë përmbys.*) Atë e di unë. Nuk kemi tjetër? Kam frikë a do të më dalin të shijshme pa...

ERIFILI — T'u bëftë mami! Sa merak që ka! Kështu terezitë e shtëpisë s'i ka të kollajta, po nga goja është...

FAHRIA — Është... është...

ERIFILI — Mbaj mend, s'kishte mbushur akoma tetëmbëdhjetë muaj kur tha: ...S'më harrohet... E po s'besoj ta ketë thënë fëmijë që në atë moshë... E di ç'tha?

FAHRIA — Jo.

ERIFILI — «Plaç të preftë»!

FAHRIA — Çfarë?!

ERIFILI — «Plaç të preftë»! E po hë! Gjen fëmijë të tillë! Dhe s'i kishte mbushur të tetëmbëdhjetë muajt!

- FAHRIA — Plaç të preftë, të tha ty?  
 ERIFILI — Burrit... Po ç'rëndësi ka!  
 FAHRIA — Po ai ç'bëri?  
 ERIFILI — Më thirri mua... Dhe çupa na tha të dyve... Ne sa s'e mbytëm me të puthura... Pastaj i shtoi llafet.  
 FAHRIA — Epo sos do të mbetej me një «Plaç të preftë». Është dhe sarkazma.  
 ERIFILI — Edhe kur u rrit, prapë ua kalonte shoqeve. S'dinte të ulur kjo.  
 FAHRIA — Ku?  
 ERIFILI — Në mbrëmjet e vallëzimit... Hidhu e kërce... Hidhu e kërce. E papërtuar. Mezi po pres ta shoh se ç'do të na gatuajë!  
 FAHRIA — E po me tërë këto që po më tregon zotrote, moj krushkë, e me sa e njoh unë, merret me mend se ç'do të na gatuajë.  
 ERIFILI — Shpirti i mamit!

*Kalon Vera e përlotur duke u kollitur e duke fshirë duart me përparëse.*

- VERA — E lava prapë tenxheren.  
 ERIFILI — Atë që kishe vënë në zjarr?  
 VERA — Atë. E derdha dhe i futa një të larë.  
 FAHRIA — Pse?  
 VERA — Ngatërrova shishet... Në vend të hidhja vaj ulliri...  
 FAHRIA — Hodhe vaj luledielli?  
 VERA — Jo... Vajguri!

*Del dhe kthehet me një sëpatë në dorë.*

- FAHRIA — Ke plot dru të çara aty. Ç'e do sëpatën?  
 VERA — Më duhet për pulën!

*Hyn në kuzhinë. Kakarisje, përplasje kra-hësh.*



ERIFILI — Po mundohet.

*Shfaqet përsëri Vera që shkon në kutinë mjekësore.*

FAHRIA — Mos u preve, moj nuse?

Vera — *(Duke u mjekuar.)* Jo jo, asgjë... *(Lidhet me garzë duke kënduar.)*

ERIFILI — Po më, moj bija e mamit, një pulë nuk ther dot?

VERA — Unë do ta kisha therur, moj mami, po ajo më kundërshton.

*Hyn në kuzhinë. Përplasje legeneshe, krahësh, zhurmë e kakarisje.*

FAHRIA — Thuaje copë, a të vijmë të të ndihmojmë!

VERA — Jo dhe jo. Darkën sonte e keni nga unë. *Dëgjohen përpjekjet e saj... Një këngë që vazhdon në një finale me kulminacion të zgjatur... që zgjat pak si shumë.*

ERIFILI — *(Që po kënaqej me këngën nis të shqetësohet.)* Mos e zgjati një çikë si shumë këtu? *(Futet me vrap në kuzhinë. Që andej vjen dhe klithma e saj.)* A a a a a! *(Shfaqet te pragu, e alarmuar.)* Po në kuzhinë është bërë nami moj krushkë!

FAHRIA — E theri çupa pulën?

ERIFILI — Jo, e zeza unë? Pula ka therur çupën! *Bie në kolltuk gjysmë e alivanosur. Në prag duket Vera me krah të fashuar komplet e të varur me garzë në qafë. — Dy tre leukoplaste në fytyrë. Sytë i ka të mbushur me lot.*

VERA — *(Fahries.)* Mama, më fal!

FAHRIA — Përse, moj nuse?

VERA — Pula e dajës...

FAHRIA — Hë...

VERA — Fluturoi nga ballkoni e ra mbi një zetor.

FAHRIA — Edhe?...

VERA — Zetoristi nuk e pa dhe e mori me vete...  
(Qan.) Iku pula në fshatin e saj të lindjes!...  
Hm! Hm!

ERIFILI — Mos qaj, mos qaj! Po në këtë pjatë ç'ke?

VERA — Darkën... Ju leva bukën me gjalpë... Mirse  
na erdhët, mama!...

## KULTURA QË DUKET

### LIBRASHITËSI NJË GRUA

*Në një librari. Vjen një grua e veshur gjoja me modë.*

GRUAJA — Mirëdita!

LIBRASHITËSI — Mirëdita! Urdhëroni, shoqe!

GRUAJA — Desha disa libra.

LIBRASHITËSI — Urdhëroni, do t'ju shërbejmë me gjithë qejf.

GRUAJA — Mund t'i shoh pak etazherët?

LIBRASHITËSI — Posi! Ja, urdhëroni!

*Gruaja shikon përreth e pakënaqur.*

GRUAJA — Nuk ka librari të tjera?

LIBRASHITËSI — Ka edhe librari të tjera, por kjo është qendrorja... Po nuk e gjetët këtu atë që kërkoni, nuk besoj ta gjeni në të tjerat.

GRUAJA — Sa keq!

LIBRASHITËSI — Më falni, nëse mund t'ju ndihmoj! Çfarë kërkoni ju?

GRUAJA — Po sigurisht libra kërktoj!... Nuk po kërktoj terital!

LIBRASHITËSI — E kuptoj. Doni shumë?

GRUAJA — Shumë.

LIBRASHITËSI — Doni autorë shqiptarë apo të huaj?

GRUAJA — Të huaj, të huaj... Por të ndryshëm.

LIBRASHITËSI — Po ju ndihmoj atëherë... Sa doni?

GRUAJA — Nja gjashtë metra.

LIBRASHITËSI — Siiii?!

GRUAJA — Gjashtë metra... domethënë...

LIBRASHITËSI — Më falni, po këtu librat shiten me copë, me autorë dhe jo me metra as me kilogramë... Këtu është librari... Porositë bëhen veç e veç.

GRUAJA — E di, e di që porositë bëhen veç e veç... Mua gjashtë metra më duhen gjithsej. Po unë do t'i ndaj... Një metër e gjysmë i dua me kapakë bojërozë dhe po aq i dua me kapakë bezhë, lila e bojë preshi.

LIBRASHITËSI — Doni libra bojë preshi?! Unë kam tridhjetë vjet librashitës dhe porosi të tilla askush nuk më ka bërë! Më kërkojnë autorë të vendit e të huaj dhe më vjen keq kur s'më ndodhen, po të vish e të më kërkosh gjashtë metra Stendal bojë preshi!...

GRUAJA — Po kush të tha gjashtë metra bojë preshi?! Një metër e gjysmë po ju them.

LIBRASHITËSI — Moj shoqe, thuajeni troç, do të blini?

GRUAJA — Po do të blej, mor shok... Nuk kam ardhur të kaloj kohën këtu. Ja, bile kam marrë edhe karrocën.

LIBRASHITËSI — Karrocën?! I doni për ndërmar-  
rrjen?

GRUAJA — Jo, i dua për vete.

LIBRASHITËSI — (Prerazi.) Flisni atëherë, çfarë  
doni?

GRUAJA — Ju thashë. Dua gjashtë metra libra.

LIBRASHITËSI — (Që zien përbrenda.) Bojë preshi!...

GRUAJA — Jo de, jo të gjitha bojë preshi!

LIBRASHITËSI — Kjo është e bukur... Këtu kër-  
kon libra në bojë preshi, në pazar presh në  
formë librash... Po a mund t'ju pyes, përse  
i doni?

GRUAJA — Ua, nuk e kuptoni? Kam bërë një bi-  
bliotekë me fibër mileoglas... Ngjyrë ari... E  
kam vënë në dhomën e pritjes. Dhomën e  
kemi ngjyrë gri të lehtë... Tavani është në  
ngjyrë blu të thellë... Kolltukët janë bezhë...  
Televizori ka ngjyrë të bardhë... Burri e  
pëlqen shumë... .

LIBRASHITËSI Po ai ç'ngjyrë ka?

GRUAJA — Kush?

LIBRASHITËSI — Burri.

GRUAJA — Vjen pak i bronzët... Unë bjonde e  
shkojmë shumë... Ju po qeshni, po unë u vë  
shumë rëndësi ngjyrave... Një profesor i huaj  
në televizor shpjegonte se në botë ka harmoni  
kur ka harmoni ngjyrash. Dhe kur ngjyrat  
nuk shkojnë me njëra-tjetrën, atëherë edhe  
njerëzit grinden.

LIBRASHITËSI — Ashtu?!

GRUAJA — Posi... Mua. p.sh., më pëlqen shumë  
gjalpi... por bukë me gjalpë nuk ha kurrë.

LIBRASHITËSI — Pse?

GRUAJA — Nuk më shkon me të kuqin e buzëve.

LIBRASHITËSI — Ah! Po më çuditni!

GRUAJA — Kur më vijnë njerëz për vizitë, po nuk më shkuan me ngjvren e kolltukëve, i fus në kuzhinë.

LIBRASHITËSI — Kjo qenka e bukur! Po kur vjen ndonjë çift e kur gruaja shkon me kolltukët e burri nuk shkon, ju i ndani? Burrin e degdisni në kuzhinë, ëh!

GRUAJA — Po e shikoj që po habiteni, por unë dhomën e pritjes e kam idealin tim... Tani do ta pajis edhe bibliotekën... Do të m'i jepni ngjyrat që ju kërkova?

LIBRASHITËSI — Moj shoqe, këtu është librari... Librari do të thotë kulturë. Njerëzve u pëlqejnë librat jo nga ngjyra e kapakëve. Ata e kanë bukurinë brenda, jo jashtë...

GRUAJA — Eehej!... Po ju pse merrni zjarr?

LIBRASHITËSI — (*Dulce shfryrë.*) Se duhet të shkoni te bojaxhiu, jo në librari... Dëgjuat? Dilni jashtë nga lokali!

GRUAJA — (*E trembur.*) Ua!... ç'është kjo sjellje?

LIBRASHITËSI — Jashtë!

GRUAJA — Ua! U çmend! E pse të dal? S'dua!

LIBRASHITËSI — Nuk më shkon me ngjyrën e dyqanit! Jashtë!

## U BË PUNA ME DRU

*Në skenë del me një dru të gjatë në dorë një plakë e vjetër, energjike.*

...Do, s'do, je e detyruar të rrëmbesh drunë... Nuk i dilet ndryshe... Dhe fajin nuk ma ka vetëm nusja... Djali ca më shumë... Plasëm. Qilimi në dhomën e pritjes, akvariumi me peshq, televizori. Në gazetat varda: — Jetoni thjesht. Kursimi në familje. Ne hiçgjëkundi. As unë, as im bir, as nusja, Poli. Po unë, ç'të bëj unë?...

Ëndrra e nuses të plotësojë shtëpinë... Ëndrra e djalit të plotësojë tekat e nuses... «Dua kolltukë! Kolltukë për dhomën e pritjes.» U blenë! Ca kolltukë të bukur. Të kishte lezet shpirti të uleshe në to. Por unë s'e pata lezetin të gjatë se sapo u ula Auuuu! — uluriti nusja. Ca nga sustat dhe ca nga që më tromaksi nusja kërcëva në tavan. «Ç'pate, moj nuse?» — i thashë. «Po mos u ul atje, moj në-

në, se i prishen sustat.» «Le që s'prishen kollaj, — i thashë, — po paçka, ne për t'u ulur i blemë!» «Për të ulur, natyrisht, për t'u ulur, po jo ne. Ata që do të na vijnë për vizitë.»

E që atë ditë, meqë nuk është zakon të bësh vizitë në shtëpinë tënde unë as jam ulur dhe as kam për t'u ulur më në ta...

Kur erdhi krushku, i ati i nuses, që marshalla është nja 120 qillo, dhe më pa që rrija kreko në karekllë më tha: «Po eja ulu këtu në kulltukët, moj krushkë!» Vajta u ula dhe për kokë të djalit m'u këput kurrizi. Vu më vinin djersët (*Duke qeshur.*) se bëja sikur rrija ulur, po e vërteta rrija me bisht nga që nusja s'm'i hiqte sytë.

Po më e bukur është ajo e damaskut. Copa e kolltukëve kishte qëlluar një damask i bukur i Beratit me çërka që të prishte mendjen nga bukuria. «I bukur, moj Poli, po do të të ndotet, — i tha një shoqe, e po u ndot s'ke si e lan.» «Të nësërmen kolltukëve iu bënë mbulesa, tak-fak. Çështë e vërteta ime re e zgjodhi copën e mbulesave dhe ato dolën shumë të bukura.

«Gjynah, moj Poli, — i tha një shoqe tjetër. — Mbulesa po të mori njollë do ta lash, po kjo basmë s'mban të larë.»

Dhe nusja na bëri përsëri mbulesa të mbulojë mbulesat. Shtresa, mbulesa, damasku i Beratit mori fund. Unë plakë jam, as do ta shoh më, po rrezik a do ta shohë i biri i tim biri, Coli?

Po pecetat, moj aman.. Kur qeras me fruta dhe ëmbëlsira u nxjerr pecetat e bukura të qëndisura dhe të hekurosurat thikë, sa të vjen të presësh mollët me to... Bukur! S'them jo... Po ka njeri që i fshin duart me to... (*Duke qeshur.*) Hë, më thoni



ju: kur u nxjerrin të tilla peceta të bardha të hekurosura i fshini? Jo... Ha, ha, ha! Tërë nxjerrin shaminë... Dhe kur s'u ndodhet shamia, burrat i fshijnë në astaret e xhepave, kurse plakati e zamanit pas çitjaneve. U tërbua nusja ime kur ustai që na hapi lavamanin, pas qerasjes, i fshiu duart në një pecetë të tillë. Dhe kur ai u ngrit e iku, Poli e nxori avullin si ajo tenxherja me expresion: «Minjoranti! Po pse për të fshirë duart janë këto?! Minjoranti!»

(*Duke qeshur.*) Po ke lodrat e fëmijëve ti. Hëm. Nuk ua lë. Kur blihet ndonjë lodër në shtëpinë tonë, më shumë gëzohet ajo se të vegjëlit, Oli dhe Coli. Ata nga gëzimi s'fllenë një natë. Ajo s'fle tri net. «Mos i prekni, ju bëftë mami se janë shumë të bukura... Gjynah të lozësh me to se prishen... Ja, t'i vërë mami në bufet... kur të vijnë ato tetat, shoqet e mamit, t'i shohin.» Dhe kur vijnë shoqet e mamit kris muhabeti i lodrave. Unë kam majmun më dauille, po ti? Jo unë kam ariun fotograf. Të të jap një pehlivan më jep një qen me lesh?

Dhe i kanë mbushur bufetë me lodra, që rrinë kot, ndryshken e nuk lëvizin, ashtu si i ka rregulluar ustai për të gëzuar kalamanët.

Kështu, xhan, kështu në shtëpinë tonë kemi plot e s'kemi asgjë. Për botën ne kemi plot, por vetë e shohim që asgjë s'na hyn në punë. Kemi jastëkë po nuk mbështetemi, kemi peceta, po nuk fshihemi, kemi kolltukë, po nuk ulemi. Kemi lodra, po s'janë për fëmijët... Kemi qilimë po nuk i shkelim.

Dhe vjen një ditë, do s'do, do të rrëmbesh drunë... Urdhëro? Si the? Ç'e dua drunë? Jo për nusen, as për djalin. Jo! Jo! E dua se më ra një



gjep penjsh e m'u rrokullis mu në mes të qilimit...  
Po s'kam si e marr. Kush të lë ta shkelësh qilimin.  
Pa-pa-pa!

*(Del me dru në dorë.)*

## **RRUFE NGA MALI**

*(pjesë me një akt)*

**KOMANDANTI I SPITALIT PARTIZAN**

**DOKTORI I SPITALIT PARTIZAN**

**AGUSHI** — partizan

**RUSHITI** — partizan

**XHA BEQOJA** — plak patriot i lidhur me Luftën  
Nacionalçlirimtare

**RREMOJA** — komandant ballist

**GANIU** — ballist

**HALOJA** — ballist

Ngjarjet zhvillohen gjatë Operacionit armik të  
Dimrit, janar 1944.

## PAMJA E PARË

*Në mal. Në sheshin përpara shpellës ku është strehuar spitali partizan. Nëpër shesh kalon komandanti i spitalit partizan.*

AGUSHI — *(Që pas.)* Shoku komandant! Kërkove doktorin më duket?

KOMANDANTI — Po.

AGUSHI — U lirua doktori... Po lan duart.

*Komandanti kthehet.*

KOMANDANTI — Po ti, Agush, e le rojën?

AGUSHI — Po, po... Ia dorëzova Rushitit... Por... po qepja opingat e vajta i ngula gjilpërën dorës... Erdha te Miçoja të ma ngalloste me ca tentërojod...

KOMANDANTI — Po Miçoja aty sikur ishte.

AGUSHI — Aty ishte, por gjë në dorë më s'kishte... Shishen e tentërojodit e mban doktori tani... Në dollap me kyç... Ohua, si qe bërë puna... Duhej të ma shikonte ai e... Pa ik. Guçe, i thashë vetes se është turp. S'ka hallin tënd doktori tani... Po i hedh ca duhan përsipër. Kështu jemi rritur ne...

KOMANDANTI — *(Buzëqesh.)* Po duhan a ke?

AGUSHI — Jo! Do të kenë shokët.

KOMANDANTI — *(Duke nxjerrë qesen e duhanit.)*  
Na! Merr nga ky imi.

AGUSHI — *(Duke i vënë dorës duhan.)* Ashtu... Meqë është duhan i komandantit të spitalit partizan, ky duhet të jetë ilaç i ilaçeve.

KOMANDANTI — More Agush, ti je nga Lajthiza... Ky xha Beqoja ku e ka shtëpinë?

AGUSHI — Mu në mes të fshatit, shoku komandant, Përroi e ndan nga xhamia.

KOMANDANTI — Mirë që më kujtove përroin... Çfarë lë përroi më të djathtë e ç'lë më të majtë, ë?... Pa ma bëj këtu me laps. Të shohim si mund të shkohet në shtëpinë e xha Beqos.

AGUSHI — Përroi ndahet e bashkohet dy herë. Ja këtu e këtu... (*Skicon ngathët me laps.*) Ja shtëpia e nënë Xhevries... Këtu janë Rrapet... Po dale se Rrapet më dolën më poshtë se xhamia... E ngatërrova! U thye dhe kalemi. E di ç'ke ti, komandant! Po pate ndonjë hall vete unë atje.

KOMANDANTI — Prit, prit, se nuk vete dot...

AGUSHI — Oh! M'i lidh sytë që këtu... Për dy sahat, po s'trokita në derë të xha Beqos, mos më thënçin Agush.

*Vjen doktori.*

DOKTORI — Urdhëroni, shoku komandant!

KOMANDANTI — Hë, doktor!

DOKTORI — Nuk di ç'të them... I preokupuar jam... Është një gjendje që kapërcehet lehtë, por kështu pa ilaçe mund të komplikohet...

KOMANDANTI — Ilaçet kanë ardhur në fshat poshtë.

DOKTORI — (*Nuk u beson veshëve.*) Kanë ardhur? Në Laithizë?

KOMANDANTI — Po, shokët e qytetit, me gjithë vështirësitë e operacionit armik, kanë mundur të na dërgojnë një arkë plot. Ndodhet në shtëpinë e xha Beqos...

DOKTORI — Dhe ti, o komandant, na e thua kaq thjeshtë sikur kjo s'është asgjë?

AGUSHI — Po ti thuaje, o komandant! Ç'e mban? Unë i gjori gër-vër, me laps! Jo xhamia, jo Xhevria! Thuamë, të vete me Rushon.

DOKTORI — Kur do t'i tërheqim?

AGUSHI — Për mua, doktor, në darkë i ke në dorë. Kanë nevojë shokët, o komandant... Të nisemi!

KOMANDANTI — Prit, Agush! Nuk është kaq e lehtë tani.

AGUSHI — Aman, o komandant, më qafsh! Lidhmi or sytë, të thashë... Pa shkelur as gur as gropë drejt e te xha Beqoja më ke.

KOMANDANTI — Korrieri, që ka dërguar kryetari i këshillit të fshatit, nuk na sjell lajme të mira... Dje në mëngjes fshatin e kanë zënë forca të shumta gjermano-balliste. Këshilli mori masa që fshati të boshatiset. Aty kanë mbetur veç ca plaka e pleq. Çeta balliste e Rremo Qorrit djeg e shkreton fshatrat përqark. (Pauzë.) Ja, kjo është gjendja.

DOKTORI — (Qetësohet pas një pauze.) Ilaçet për ne janë çështje jete, komandant!

KOMANDANTI — Pse unë nuk e di?!... (Pauzë).

AGUSHI — Dërgomë mua, o komandant... Nëm vetëm Rushitin. Ne ta njohim fshatin pëllëmbë për pëllëmbë. Aty fshehur, aty ngrehur e puf te xha Beqoja!

KOMANDANTI — Po këtu është belaja, dreqi ta hajë! Te xha Beqoja ka zënë konak vetë Rremo Qorri me atë luan e tij, Gani Llapën. Aty janë plasur.

AGUSHI — Fiiiiu!

DOKTORI — (Si me vete.) Po të tërheqim të paktën tintur jodi, acid borik, aspirina... Nja dy bisturi... Le që kush i njeh ato. Duhet arka e tërë, duhet...

KOMANDANTI — Po dhe ne nuk dimë saktë...  
Ore Agush, po hë, ore, na i vizato... Ja  
këtu, përdhe.

AGUSHI — (*Merr pa qejf një shkop.*) Po nuk di  
nga këto unë, o komandant. Po ja përroi...  
Ja u nda këtu. Ja u bashkua. Ja nënë Xhe-  
vria... Ja xhamia... Ja mulliri...

KOMANDANTI — Po mulliri nuk është këtu lart?

AGUSHI — Lart nuk punon ai... S'i vete ujët.

KOMANDANTI — Jo, them, më lart se xhamia.

AGUSHI — Mulliri lart, xhamia është poshtë.

KOMANDANTI — E de! Po ti na ngatërron, thua  
s'i vete ujët!

AGUSHI — (*Flak shkopin.*) O shoku komandant, nuk  
e ke për këto Guçen! Do më japësh Rushi-  
tin mua ti. Le të jenë zënë gjermanët e  
ballistët dora-dorës. Të mos hyjmë dot në  
fshatin që na ka rritur, haram buka e na  
zëntë sytë!... Ne njohim edhe ferrat sa  
gjemba kanë!...

KOMANDANTI — Prit, Agush!...

AGUSHI — Ore, mos më shiko në këto pikturat  
mua ti... Kështu unë i ngatërroj të tëra.  
Mullisin ta hip në minare dhe hoxhën e  
vë të bluajë... Doktor, thuaji dhe ti një  
fjalë, më qafsh! Na nisni e të shohësh po  
s'të solla unë tentërrjod, ç'janë ato borigat,  
aspirinat, kininat e tarnaninat...

DOKTORI — Unë them, shoku komandant, që Guçja...

AGUSHI — Mendoni për shokët e plagosur, ko-  
mandant.

KOMANDANTI — Pse për ata të shëndoshët nuk  
duhet të mendoj?

AGUSHI — Ç'po bëjmë në këtu, shoku koman-  
dant! Shokët tanë përleshën fyt a fyt me

gjermanët. Ç'detyrë qenka kjo jona!... Rri rojë e hiç asgjë.

KOMANDANTI — Prapë, ti Agush! Detyrë e paktë është të mbrosh spitalin partizan?!

AGUSHI — Ta mbrojmë, ta mbrojmë... Po pse vetëm ta mbrojmë? Ja, tani paraqitet rasti të sulmojmë. Pse të mos sulmojmë? Eh, doktor. Fol, o komandant!

KOMANDANTI — Duhet rrezikuar, por deri në një farë pike. Plani duhet menduar hollë... Pa ejani ta pleqërojmë me shokët...

AGUSHI — Ashtu de!... Tani ka lezet.

*Dalin.*

### PAMJA E DYTË

*Në fshat. Në shtëpinë e xha Beqos. Në dhomë ndodhet xha Beqoja dhe ballisti Halo.*

HALOJA — Hajde, plak zevzek. Këto gjeta unë për kumandarin. Shtro sofrën.

BEQOJA — Si urdhëron, o qilar i komandarit!

HALOJA — Si qilar?! Pse qilar?!

BEQOJA — Si qilar të ka. Tërë të mirat ia sjell ti komandarit.

HALOJA — Këto meze që solla unë as mua nuk më dalin e jo më komandar Rremos që të ha qengjin e pjekur një kafshatë.

BEQOJA — S'kam, o zoti ballist. Ato katër pula që kisha i zutë, ua përdrohdhët qafën e i gëlltitën komandarët tuaj që natën e parë... Fukara jam unë... Shtëpitë e kamura i zunë gjermanët... Këtyre tuajëve u pëlqen mesi i fshatit e u plasën tek unë... Hanë mesin tani!

HALOJA — Ore, lëre mesin ti!... Unë i them meze, ai thotë mesi.



BEQOJA — Ore trim me fletë, e di ti që në këto vise mesi është më i mirë se mezja?... Se mezja të mban barkun, kurse mesi të mban kokën... Se sikur të zbresin e t'ju bien ata të malit... Ëhë! Në mes të fshatit ja ca më i sigurt, de!

HALOJA — Ça të malit mo, ça të malit!... Që kur filloi ky operacion... Na... U shuan... U bë muaji — gjëkund i s'duken!

BEQOJA — Jo, oree! Po në Gurzë, javën që shkoi, me kë luftuat, o trim i fushave?

HALOJA — Ja, ata ishin të fundit...

BEQOJA — Po të pesnesërmen, në Valie, kush ju goditi brinjën, o sysqifter?

HALOJA — Ata ishin të fundit fare...

BEQOJA — Po para tri ditësh kush ju nxori nga Lumasi, o hundëzhgabonjë?

HALOJA — Hëm!... Nuk na nxorën ata... Dolëm vetë... Ata ishin të fundit fare. S'ka më.

BEQOJA — Thonë se janë ca të fundit fare, fare, fare, që janë më shumë se ç'kanë qenë... e ata të bien ku të dhemb e ku të djeg.

HALOJA — Pallavra... Në këtë operacion s'bëhen të gjallë ata! Vrima e miut, pesëqind grosh!

BEQOJA — S'dihet, o mendjedëruar i Ballit, jo!

HALOJA — Vër një mangall këtu!

BEQOJA — Si urdhëron, or oxhak i komandarit!

HALOJA — Të ngrohet ky... kotec!... Ka ftohtë komandari.

BEQOJA — Si urdhëron, o nevojtoe e komandarit!

HALOJA — Nevojtoe?! Si nevojtoe?! Ç'domethënë nevojtoe?

BEQOJA — Domethënë se ç'do nevojë që ka komandari ti tak — ia plotëson.

HALOJA — Ëhë! Thashë se... Matuf! (*Bën të dalë*).  
BEQOJA — (*Që pas*) Hajvan!  
HALOJA — (*Kthet.*) More, mos më the gjë hajvan?

BEQOJA — Jo, more zotëri!... Thashë duhet ngrohur mirë se s'ka tavan.

HALOJA — Ëhë! Po dal!

BEQOJA — Qafën thefsh! (*Haloja e shikon me dyshim.*) Thashë mirë u kthefsh! (*Haloja del.*) Eh, më zutë ngushtë, more qena! Dhe kur të ikni zjarrin, keni për t'i vënë kësaj karakatine. E di unë. Kështu keni bërë edhe gjetiu. Dihet! Mua mali më pret, por halli i ilaqeve!

Zëra nga jashtë — *Kush kalon atje?*

— *Ne, ne. Kemi një dash të pjekur për zotin Rremo, komandantin.*

— *Kaloni!*

*Në paraskenë shfaqen Agushi e Rushiti me një dash të pjekur të shkuar në hell... Ndalen në vend, ngaqë një patrullë gjermane, që nuk duket, i thërret nga pas.*

— *Alt! Wer ist da? Wohin?*

AGUSHI — (*Nën zë.*) Gjermanët! (*Gjermanëve.*) Zoti gjerman... Ëë... ain... dash... Dash. Pjekung! Pjekung! Fyr komandanten, ballisten, herr Rremon. (*Rushitit.*) Hej, ç'do të na e marrin këta!...

Zëri i patrullës — *Passen! Schnell!*

RUSHITI — Kaloni thotë, ëh?... Dashit këta i hapin rrugë të gjithë.

*Kur nisen u del përpara Haloja me dy ballistë të tjerë.*

HALOJA — Cilën gojë do zërë ky dash, more djem?

AGUSHI — Gojën e zotit Rremo Qorri. Po ka mish aty për Rremon e për tërë ata që i rrinë afër.

HALOJA — Hajde dash, hajde! Kush e dërgon?

AGUSHI — Një mik i zotit Rremo. Mos ia thoni emrin tha... Zoti Rremo do ta kuptojë vetë e do të pijë për shëndetin tim.

HALOJA — Shpjereni brenda! Dash për kokën e dashit... (*Kujtohet.*) Pa prisni!... Jemi në luftë apo jo?... Çdo gjë ndodh. Pa t'ju kontrollojmë nga xhepat një çikë. Ashtu!... (*U bën një kontroll të imët në trup.*) Kaloni, kaloni... Jemi në luftë. Të ikën koka.

*Djemtë futen brenda. Lëshojnë dashin mbi sofër dhe nga barku i dashit të pjekur nxjerrin revolverët dhe bombat.*

*Beqoja shtang.*

BEQOJA — Guçe! Rusho!

AGUSHI — Shtt, xha Beqo (*Heton përqark.*) Ku janë këta?

BEQOJA — Akoma s'kanë ardhur.

RUSHITI — Kemi dy orë fshehur në përrua.

BEQOJA — Hë më ju lumtë... Ju pifsha dollinë!...  
Mua s'më mbante vendi. Ua sollën lajmet?

RUSHITI — Po, xha Beqo, po... Shtëpitë tona  
duken shkretë...

BEQOJA — S'ka njeri, jo, shkuan tutje nga Grizha.  
Po ju mos u merakosni. Me fshatin janë.

AGUSHI — Të mos humbim kohë, xha Beqo. Ku është arka me ilaçe?

BEQOJA — E kam fshehur mirë. Po si do ta merrni?

AGUSHI — Do ta tërheqim në përrua njëherë.  
Pastaj ca nga ca... duke u ruajtur... kemi natën përpara.

- BEQOJA — Eja ta nxjerrim, Rushit!
- RUSHITI — Ssst! Ndihen zëra!
- BEQOJA — Ata janë! S'ma mori mendja të vinin  
kaq shpejt. Nuk e kanë zakon.
- RUSHITI — Dashi, Guçe! Na ndihmoi të vijmë  
pa telashe deri këtu, po harruam se do të  
ndjellë Rremon shpejt e ata do vijnë si  
korbat te kërma.
- AGUSHI — Bujrëm... Tani fillon avazi... (*Mendo-  
het. Maskon një palë opinga poshtë një  
perdeje që veçon një të ndarë.*) Të duket  
sikur nuk jemi vetëm ne të dy... (*Prapa një  
perdeje tjetër me një shkop imiton grykën  
e një pushke.*) Na duhet edhe ky fyelli.  
(*E mbulon më një qilim pas sëndukut dhe  
vë mbi të kapelen.*)  
E po dalçim faqebardhë tani! (*Fshihen.*)  
*Hyjnë Rremo Qorri, Gani Llaja dhe Haloja.*
- RREMOJA — Më thanë për një dash... Sa mirë  
kur mendohet për komandantin! Ashkoll-  
sum!
- GANIU — Mmmm... Ç'dash!
- RREMOJA — (*Halos.*) Shiko për rojat ti. Këtu rreth  
shtëpisë forcoi ca më shumë. Fryu tani!  
(*Haloja del.*) Ehë! Opo na u mbarua kjo  
shishe, ç'do të pimë?
- AGUSHI — (*Duke dalë me revolver në dorë.*) Do  
të pini nga një plumb në ballë, po të bëni  
zë... Hajt trimat e xhaxhait, duart lart!
- RUSHITI — Duart lart!  
(*Rremoja dhe Ganiu shtangen.*)
- AGUSHI — Lart duart, zoti Rremo!
- RREMOJA — Ç'është kjo? (*Ngre duart.*) Pthut!...  
Do ta paguani shtrenjtë!

RUSHITI — Mbylle grykën! Xha Beqo! Merru armët!  
*Xha Beqoja ia nxjerr revolen Ganiut, Rremoja kundërshton.*

AGUSHI — Lëri trimëritë, o ti aga i Vadhishtes, se ne jemi bërë gati për të gjitha... Dorëzo armën!

BEQOJA — Na e jep sa je në këmbë, buçko, se ne ta marrim edhe pasi të të shtrijmë...  
*(Ia merr.)*

AGUSHI — T'i bëjmë punët me qetësi... Xha Beqo, shko nxirr arkën... Ti, Rusho, tërhiq pak... Ju të fshehurit, asnjë lëvizje! Sus, dhe mos shtini pa urdhrin tonë, përndryshe përgjigjeni me kokë! Qartë?  
*Rremoja dhe Ganiu shohin përqark të trembur dhe të habitur.*

AGUSHI — Ju, zotërinj ballistë, hëpërhë s'ju kërcënon asnjë rrezik, po të mos doni vetë. Ne jemi një skuadër partizane që...

RREMOJA — Skuadër? *(Shikon përreth si i goditur.)*

AGUSHI — Po ç'the, zotrote!... Jemi dërguar me një mision këtu. Kemi marrë parasysht të lëmë kokën po qe nevoja. Por ama në atë botë do t'ju dërgojmë ju përpara... Kështu, nipat e xhaxhait.

GANIU — Po sikur t'ju diktojnë të tjerët?

AGUSHI — *(Qetë.)* Nuk do të na diktojnë. Do të na ndihmoni ju... Ndryshe po u zbuluam, pisk e kemi të dyja palët... Ju fluturoni me të parën, kurse ne, zor të çajmë rrethimin... Një skuadër me shtatë a tetë veta nuk e ka të lehtë me një qetë ballistësh e një kompani gjermane. Po më mirë të mos ndodhë kjo. Si, thoni?

GANIU — Më mirë, më mirë-oo!

AGUSHI — Sa veta ka çeta juaj? Hajt, ju bëftë  
xhaxhai...

GANIU — Ky është komandanti.

RREMOJA — (*Fare pa qejf.*) Një... qind e pesë-  
dhjetë e një!

GANIU — Janë dhe gjermanët.

AGUSHI — E dimë. Sa bëhen ata?

GANIU — Shumë.

AGUSHI — Numrin! Hë de!

GANIU — Ky e di.

RREMOJA — Njëqind.

*Dëgjohen këngë.*

AGUSHI — Ç'është ky aheng?

RREMOJA — Janë ballistët tanë... Në tërë kona-  
qet pinë e këndojnë.

RUSHITI — Përse këndojnë... Për shtëpitë që  
kanë djegur?

GANIU — Ore, të këqijat s'vijnë nga ne, ore, po  
vijnë nga ata tedesgot. Neve na qan zemra,  
po ata... Dhe për të kënduar ata na kanë  
urdhëruar... Se ç'kanë një festë sot ata.  
Hitleri i tyre ka ardhur në fuqi tani në  
janar, eh Rremo? Hë, o zoti Rremo, fol  
dhe ti de!... Se të dyve na ka duk, fjala.

RREMOJA — Ah, mos paçim kokën ne... Është  
dhënë urdhër që të festohet, të ketë valle,  
këngë...

*Zhurme nga jashtë. Të folura gjermanisht.*

AGUSHI — Gjermanët?!

RREMOJA — Po. Patrulla.

AGUSHI — Keni punë me ta? Mund të vijnë  
këtu?

RREMOJA — Jo.



GANIU — Po sikur të kenë ata me ne. Obobo!  
AGUSHI — Gati për zjarr! (*Një shoku të ima-  
gjinuar.*) Mos e lëviz perden ti!

GANIU — Ishalla s'vijne!

RUSHITI — (*Që sheh nga dritarja.*) Po bëjnë she-  
një këtej.

AGUSHI — Uluni në sofër!

RREMOJA — Si?!

AGUSHI — Uluni... Pini... Ne jemi ata që ju  
shërbejmë.

*Ballistët ulen. Hanë e pinë.*

RREMOJA — Farmaq më duket... Ah, këtë s'e  
kisha menduar!

AGUSHI — Lëri këto, zoti Remo!... Pi rehat  
sikur skuadra jonë të mos qe fare këtu.  
Mos i var buzët, o aga i Vadhishtes... Je  
hërë sterrë, sikur të kanë marrë çifligjet...  
Ka kohë për atë punë... Tani pi dhe merrja  
këngës.

RREMOJA — Këngës... Ç'thua mo. dhe këngë do  
këndojmë? Pthu!

AGUSHI — Dhe me qeif bile. Hë. Rushit!

RUSHITI — Akoma s'kanë ikur... Si duket dyshoj-  
në për diçka...

AGUSHI — Shokë të skuadrës, gati! (*Ganiut.*)  
Këndoni, ju!

RREMOJA — Merrja, Gani. Unë po ta mbai.

GANIU — E ku kam fuci unë... M'u zu zëri!

Këndon: Hapmi syt' e zez, moj,

hapmi syt' e zez:

hapmi syt' e zez, moj...

Rremoja ia mban.

RUSHITI — Më fort!



GANIU — (*Më fort.*) Hapmi syt' e zez, moj,  
të na sjellsh beharë;  
sa të dua ty, moj,  
sa nëna evlanë...

RUSHITI — Kujdes, Guçe!... Po i afrohen dritares.

AGUSHI — Sa janë?

RUSHITI — Gjashtë veta.

*Rushiti tërhiqet anash. Agushi mban një qëndrim të natyrshëm me revolverin nën pecetën e duarve. Në dritare shfaqet silueta e një nënoficeri. Në dhomë një qetësi varri.*

RUSHITI — (*Nëpër dhëmbë.*) Këndoni, pisa... Ata ju kanë dhënë urdhër...

GANIU — (*Fort i trembur.*) Me doçka përveshur  
mblihdje manushaqe,  
të kam për të ngrënë,  
moj,  
me gush e me faqe.

RREMOJA — (*Me fjalë nga xhepi i drejtohet Agushit.*)

Më vjen t'u dëftej,  
o më vjen t'u qaj hallë.

AGUSHI — (*Nxiron t'i përgjigjet me këngë.*)

Bëje po ta mbajti,  
që ta hash në ballë.

GANIU — (*I trembur.*) Iso, bre iso... Oiiiiiii!

*Figura e nënoficerit gjerman zhduket. Xha Beqoja sjell arkën.*

GANIU — Uf!

AGUSHI — Tani ti, aga efendi, që deshe të dridhje vithet, do t'u japësh urdhër ballistëve të tu, që xha Beqon, këtë shokun tim dhe këtë arkë t'i nxjerrin jashtë rrezikut. Sidomos t'i ruajnë nga gjermanët... (*Rremojaja niset të dalë.*) Jo, jo... Mos u mundo, zotrote... Dërgojmë xha Beqon... Shko, xha Beqo!

*Xha Beqoja del.*

RREMOJA — Ah, ata hajvanët e mi! Si more ju lanë të hyni deri këtu?

RUSHITI — Ja me fletëhyrjen e pjekur.

RREMOJA — Ua rregulloj unë atyre.

RUSHITI — Zoti ta shtoftë inatin... Po, hë zotrote!

*Vjen xha Beqoja me Halon. Rremojaja dhe Ganiu hanë qetësisht, ndërsa Rushiti me Agushin qëndrojnë gati me armët e fshehura.*

RREMOJA — Dëgjo, Halo! Kemi një arkë që s'duhet ta shohin gjermanët kur të dalë nga fshati. Merr dy veta e t'i përcillni këta deri matanë fshatit... Na, more, hajde më raporto pastaj!

HALOJA — Si urdhëron komandant!

*Del. Pas tij niset xha Beqoja.*

RUSHITI — (*Me arkën në duar.*) Guçe!

AGUSHI — Shko, Rushit... Unë me shokët e tjerë të skuadrës do të vijmë më pas, një nga një.  
*Rushiti del.*

GANIU — A të të bëj një pyetkë, o zoti partizan...  
Jo për gjë, po më mbeti peng, ç'kishte atje  
në arkë?

RREMOJA — Po ty, o Gani Llapa, ajo të mundon?  
Ç'kishte atje? Ata e morën, ti pyet! Ç'të  
duhet?... Për merak?

GANIU — Libra, komunikata?

RREMOJA — Mbylle zdëren!

GANIU — Jo, po ta dimë. Bukë? Veshmbathje apo  
ilaçe?

RREMOJA — Mbylle, or de të thonë! Vër, vër, vër...  
Ilaçe, thotë. Ka njeri që të vërë kokën në  
torbë, për një tok ilaçe, kur vetë është shën-  
doshë si molla!

GANIU — Jo, them unë.

RREMOJA — Epo jo de, kjo s'do as mend dhe as  
kalem!

GANIU — E po ç'të kenë qenë?

AGUSHI — O trumykuri i xhaxhait! Ti nuk e gjen  
dot... Për të ngrënë ne s'vuajmë; se po të  
mos kishim, nuk ju sillnim juve mish të  
pjekur... Ilaçet s'na duhen se ne jemi të  
tërë shëndoshë. Qiqër! Për atë arkë ia vlen-  
te të rrezikoheshe... Aty kishte flori.

RREMOJA — Flori?!

GANIU — Flo-flo-flori?!!

AGUSHI — Flori safi!

DY TË TJERËT — O të gjorët ne!

RREMOJA — A më ju hëngsha gurmazin o zuzarë  
të fëlliqur, që m'i latë këta të hynë këtu! Oh!

GANIU — Thashë unë, o Rremo Qorri! Po si nuk  
i gjetëm ne që u qorrofshim që të dy... Tha-  
shë unë, gjë e madhe ajo!

AGUSHI — Pssst!... Se kush po vjen.

GANIU — (Këndon.) Hapmi syt' e zez, moj...  
 RREMOJA — Mjaft or ti!... Si të këndohet xhanëm!... Eshtë Haloja ai.  
 AGUSHI — Thuaji të më përcjellë mua tani. Ju të tjerët sytë katër! Zbatoni planin! Komandën e merr Selimi.  
*Vjen ballisti Halo me një frymë.*  
 HALOJA — I përcollëm... Morën përpjetë malit. Dy herë na dolën gjermanët përpara e dy herë ua hodhëm... (Entuziast.) Nuk panë gjë.  
 RREMOJA — Kaluan?  
 HALOJA — Kaluan...  
 GANIU — Po arka?  
*Halos nuk i kujtohet. Të tjerët shqetësohen.*  
 HALOJA — Me gjithë arkë. Sa e rëndë që ishte!  
 GANIU — Jo more!... Obobooo!  
 RREMOJA — Hë, më ju lumtë! Do t'u shpërblej mirë për këtë punë unë, po përcill më parë këtë djalin. Kujdes, ëh!  
 HALOJA — Peqe... Eja! (Del.)  
 AGUSHI — (Para se të dalë.) Do të shihemi përsëri, o tahmaqarët e xhaxhait!... Dhe do të shihemi ndryshe. He, se për pak harrova... Mishi ju bëftë mirë, por më duket se nuk qe dash.  
 RREMOJA — Nuk qe dash?  
 AGUSHI — Jo, ishte cjav. Dhe para se ta piqnim, ca thoshin që ishte i ngordhur, ca thoshin që s'ishte i ngordhur...  
 DY TË TJERËT — Aiiii!  
 AGUSHI — Po jam i sigurt që gënjenin.  
 GANIU — Cilët?  
 AGUSHI — Ata që thoshin që s'ishte i ngordhur! Shëndet, buçkot e xhaxhait!... Dhe sus! (Te

dera.) Çdo, gjë mbarë po na vete. Veç për një gjë më vjen keq... Që nuk jua numëruan në ballë... por do të vijë dita...

*Ballistët mbeten si të ngurosur.*

GANIU — Po ç'ishte kjo gjëmë, o zoti Rremo?

RREMOJA — Rrufe, rufe nga zoti...

GANIU — Rrufe nga mali, thuaj... Obobo!

RREMOJA — Ah ç'do të bëj kur t'i kem duart e lira.. Heem!... S'durohet dot më! Dua të dal... Zotërinj partizanë, merreni si të doni, por unë nuk rri dot.

GANIU — Thashë unë. Kush ta sjell dashin ashtu! Obobo barku!

RREMOJA — Zoti partizan! (*I afrohet.*) Zo.. zo... zo... zooooo

*Hap perden dhe zbulon trukun. Shkon te perdja tjetër dhe zbulon që opingat janë bosh, kapela pa njeri nën të. Fyelli nuk është grykë.*

RREMOJA — Oooo oh! Na e hodhën! Koburen ma morën! Na e hodhën! Haloooo, Haloooo!

HALOJA — (*Vjen me vrap.*) Iku edhe ai... E ka-luam.

RREMOJA — Gomar! M'i mblidh të gjithë gomarët këtu!

HALOJA — Si urdhëron! (*I pavendosur.*) Gomarët e fshatit?!

RREMOJA — Jooo! Gomarët e mi. Shokët e tu!... Na e hodhën, bre... Na e punuan... Oh, oh!

## RRUGË TË MBARË!...

SHOFERI  
GRUAJA PASAGJERE  
BURRI ME KAPELE  
BURRI PA KAPELE  
PORTIERI  
TIFOZI I PARË  
RUSTEMI  
VAJZA E PARË  
VAJZA E DYTË  
DISA TIFOZË

*Në një rrugë automobilistike presin makinë tre pasagjerë — dy burra dhe një grua. Afrohet një kamion që ndalon diku larg tyre.*

SHOFERI — *(Hyn në paraskenë i penguar nga të dy burrat që i zgjasin nga një telegram.)*

Kam vetëm një vend. Se kam dhe time shoqe.

BURRI ME KAPELE — Më merrni mua. Më ka lindur gruaja. Urdhëro telegramin.

BURRI PA KAPELE — Urdhëroni dhe telegramin tim. Edhe mua më ka lindur gruaja.

SHOFERI — Edhe ty? Ha, ha, ha! Sa bukur! T'ju rrojnë vëllezër! Ç'të ka lindur ty?

BURRI PA KAPELE — Djalë.

SHOFERI — Po ty?

BURRI ME KAPELE — Vajzë. Po ç'rëndësi ka. Më thanë peshon gjashtë kile.

SHOFERI — O uuu! (Për burrin pa kapele.) Ky më tha më parë. Një vend kam.

GRUAJA — Atë vend e dua unë. Jam e para këtu! O! Këta tani erdhën.

SHOFERI — Po më lini de, të marr cigare!

*Burrat duke e penguar nxjerrin dhe i ofrojnë nga një cigare. Shoferi nuk merr asnjërin, por me zor çan drejt klubit.*

GRUAJA — Kot mundoheni... Unë s'ia lë vendin njeriu!... O! Paskan lindur gratë e punë e madhe! O! Ç'është lindja? Hiç asgjë. Sa hap e mbyll sytë? Tetë kam lindur unë! O!

BURRI ME KAPELE — Ju ka qëlluar të lindni fëmijë 6 kile?


GRUAJA — 6 kile? Mos e kanë peshuar me gjithë tët shoqe?

SHOFERI — Ha, ha, ha! Të marrim cigare njëherë. (Hyjnë në klub të katër.) Uu! Harrova për shkrepëse! (Hyjnë përsëri e dalin.) Ky shoku m'u duk se më tha më parë...

BURRI PA KAPELE — Jo t'u duk. Të thashë vërtet... E kam fëmijën e parë. E di që!

- Urdhëroni të gjithë siç jeni t'ju gostis.
- BURRI ME KAPELE** — Lëri, more, lëri këto marifete se s'ka lezet! Gostisjet lëri në shtëpi... Kur të gjesh makinë.
- BURRI PA KAPELE** — Unë makinën e kam gjetur... shoku... (*Duke i lexuar emrin në telegram.*)... shoku Latif.
- BURRI ME KAPELE** — Atë vend unë nuk do ta lëshoj kurrë, shoku... (*Gjithashtu.*) shoku Sheme.
- GRUAJA** — Moore! O! Kini respekt apo jo! Me ç'të drejtë i dilni përpara një femre. Prisni linjën. O! (*Të dy burrat seriozë i zgjasin para hundëve pa fjalë telegramet e tyre.*) Mirë, mirë hipni sipër në karroceri! O!
- SHOFERI** — (*Deri atëherë gazmor, tani shumë serioz.*) Në asnjë mënyrë! Kam artikuj artistikë. Më shtypen.
- GRUAJA** — Hë, more, hë se...
- SHOFERI** — Ja ku po e them njëherë e mirë: Shofer Bilali nuk ka thyer, nuk i thyen e nuk do t'i thyejë kurrë rregullat e qarkullimit... (*Nxjerr patentën.*) E shikoni? Akull! E kulluar, me latën e parë! Asnjë shenjë! Kur kalon Bilali kontrollorët përkulen me nderim. Mbi ngarkesë kurrë!
- BURRI PA KAPELE** — Hiqeni nga mendia! Mbi ngarkesë nuk marrim ne! Nisemi, Bilal.
- BURRI ME KAPELE** — Nuk e lejoj... Përse të merret ky shoku dhe jo unë! Përse? Përse? Apo sepse atij i ka lindur djalë e mua vajzë? Ky është një rast flagrant i nënvleftësimi të femrës... Tërë jetën femra ka qenë e përlulur, e fyer... e harruar! Kurse sot! Sot





s'të lejon njeri! Jepini babait të femrës  
vendin që i takon.

GRUAJA — E more se një femër 6-kilëshe është...  
Këtu ke një 76-she!

SHOFERI — Ha, ha, ha! Po një vend kam dreqi  
ta marrë! Një! Tjetrin e ka zënë ime shoqe.  
*Hyjnë portier Xhafoja dhe tifozi i parë.*

TIFOZI — Kurse tjetrin e kemi zënë ne! (Të pra-

*nishmit qeshin.*) E përse qeshni? Pse i zgurdulloni sytë? Nuk e njihni Xhafon, portierin e skuadrës sonë të futbollit... Macen e zezë, siç e quajmë ne tifozët!

GRUAJA — Mos na nxirr macet këtu ti shok, se ne nuk jemi minj që të kemi frikë.

TIFOZI — Xhafoja për tre orë del në fushë... ka ndeshje.

SHOFERI — Xhafo, pse s'ke shkuar që dje me skuadrën?

PORTIERI — Operuam vëllanë... Urgjent? Tani që u qetësuam po shkoj te shokët... Mbase u duhem.

TIFOZI I — U duhesh?! Siç i duhet kyçi portës!... Po s'vajti Xhafoja, rrezik të hamë shtatë!

BURRI ME KAPELE — S'keni ngrënë shtatëmbëdhjetë! Prisni autobusët e linjës!

BURRI PA KAPELE — Nuk kemi vend!

TIFOZI I — Kush ju pyet ju, more! Ju mbroni ngjyrat personale, kurse Xhafoja mbron ngjyrat e qytetit... Shikoni, tërë qyteti është interesuar t'i gjejë makinë...

TIFOZAT — Gjete, Xhafo Shyqyr! Hip, Xhafo! Bilal, nise na e ço sagllam. Bilal, do ta shohësh ndeshjen?

SHOFERI — Po... Ah, sikur të fitojmë!

PASAGJERËT — O u u u u!

TIFOZI I — Shko hip, Bilal.

SHOFERI — Më falni, po s'mund ta marr.

TIFOZËT — O u u u!

SHOFERI — Ndershmërisht më takon të marr një nga këta shokët.

*Zhurme e të pakënaqurve.*

TIFOZI I — Merre në karroceri.

SHOFERI — Kurrë! U thashë dhe këtyre. Rregullat e qarkullimit për mua janë të shenjta...  
Ja patenta!

BURRI ME KAPELE — Akull! E kulluar! Lata e parë dhe asnjë shenjë.

SHOFERI — Kur kalon Bilali...

BURRI PA KAPELE — Kontrollorët përkulen me respekt!

SHOFERI — Mbi ngarkesë kurrë! Kam vetëm një vend! (*Vjen Rustemi.*)

RUSTEMI — Një më duhet mua. (*Gaz i përgjithshëm. I fyer i përqesh.*) Ha, ha, ha! Ka gjë për të qeshur?! (*I jep dorën dhe puthet me shoferin.*) Ç'kanë këta që qeshin?

SHOFERI — (*Të tjerëve.*) E kam kushëririn e gruas... S'kam pasur hall më të madh, o Rusto! Dua t'i marr të gjithë... Të gjithë kanë nevojë të ngutshme!

RUSTEMI — Epo kur nuk i marrim, nuk i marrim dot. Nisemi.

TIFOZI I — Ti, Rusto, të kesh turp... I tërë qyteti sot ka hallin e ndeshjes... Kurse ti... E bëjmë me vota. Kush është për Xhafon?

TIFOZËT — Të gjithë.

BURRI ME KAPELE — S'ka vota këtu. Punë e madhe për sportin... Na rrahën, i rrahëm. Njësoj është. Tanët janë dhe ata.

SHOFERI — Unë i dhashë fjalën këtij.

RUSTEMI — Bilal! Je në vete ti... Kushëririn e parë të gruas ti e vë në kandar me...

SHOFERI — Prit linjën, Rustem... A do ti të turpërohem?

RUSTEMI — Merre sipër!

TË GJITHË — O o o o, nuk merr ashtu Bilali...  
kurrë!

- BILALI — (*Vë dorën te patenta.*) Të pastër do ta mbaj sa të vdes! (*Dy vajza vijnë me nxitim.*)
- VAJZA I — Shofer ke nja dy vende? (*Plas gazi.*)
- TIFOZI — Dashka dy!
- BURRI ME KAPELE — Drejt e në pilaf këto!
- GRUAJA — Prisni linjën, shoqe.
- VAJZA II — Pse qeshni, more shokë. Linjën nuk e presim dot... Për givsmë ore në repartin te Përroi i Thatë na fillon stërvitja ushtarake. (*Qetësi absolute.*)
- VAJZA I — Duam dy vende.
- SHOFERI — (*Pas një pauze.*) Pse kaq me vonesë. Kur e morët thirrjen?
- VAJZA II — Ka dy ditë por... (*Zhurmë e përgjithshme.*)
- BURRI ME KAPELE — Dy ditë? Po ju ku jetoni? Tek ne apo në hënë? Apo ju zuri gjumi? Bukur...
- RUSTEMI — Më falni, shoqe, po duhet t'ju vijë turp.
- VAJZAT — Por ne...
- RUSTEMI — Unë nuk di nieri sot ta nënvleftësojë mbrojtjen deri në këtë pikë... Ju mund të jeni të vetmet... Një orë para afatit të caktuar shokët e repartit tonë janë gati të armatosur.
- GRUAJA — Ju duhet të kishit marrë vrapin, po jo rrugës kryesore se turp kush t'ju shohë... Kurse ju vini dhe pa u skuqur i thoni kaq vetave: jemi vonë.
- BURRI ME KAPELE — Dhe kërkoni dy vende! Asnjë çerek! Le të shkoni me vonesë. Më mirë. Ndryshe do mbuloni neglizhencat tua-ja. Le të bëhet problem,

BURRI PA KAPELE — Mua s'më duket gjykim  
i drejtë ky juaji shoku... *(Sheh telegramin.)*  
shoku Latif. Ato duhet patjetër të paraqiten  
në orar... Në kohën e stërvitjes... Kurse pro-  
blem le ta bëjmë ne të gjithë.

VAJZA I — Po ne jemi vonuar me arsye, more  
shokë... Punojmë në spital. Ishim në sallën  
e urgjencës... Po bëhej një operacion.

XHAFOJA — Vëllai im! *(Kujtohet.)*... Po po po...  
Tani i njoha... Këto ishin atje. Nuk gënje-  
jnë. *(Pauzë.)*

RUSTEMI — Mos e zgjat, Bilal. Merri!

TË GJITHË — Po kur është puna kështu duhen  
ndihmuar.

TIFOZI I — Po këto edhe në këmbë mund të  
venë, more shokë... Le të vonohen dhjetë mi-  
nuta... Kurse Xhafoja... Do të na futin 7.

NJË TIFOZ TJETËR — Nuk na kanë futur shtatë-  
mbëdhjetë... Po s'gjetëm tjetër makinë, ne ti-  
fozat e nisim Xhafon me taksi... Po s'pati  
taksi, le të lozë rezerva... Kurse këto...

TIFOZI I — E mo 10 minuta janë!... Se mos plasi  
lufta!

*Qetësi e akullt. Të gjithë e shohin tifozin  
me habi dhe përbuzje.*

TIFOZI — *(E kupton fajin.)* Më falni... E kisha për  
mgyrat e skuadrës!

SHOFFERI — Tifoz i sëmurë!

BURRI ME KAPELE — Nuk ke turp! *(Të gjithë  
shohin burrin pa kapele.)*

BURRI PA KAPELE — Unë tërhiqem... Detyrat  
bashkëshortore më thërresin pranë gruas dhe  
dialit...

BURRI ME KAPELE — Uf, na hëngri ky me dja-  
lin!

BURRI PA KAPELE — Por mbrojtja është detyrë  
mbi të gjitha detyrat.

*Të gjithë shohin shoferin. Ai nxjerr patentën.*

PORTIERI — Në një rast të tillë kontrolli s'thotë  
gjë.

SHOFERI — Në asnjë mënyrë. Dëmtohet ngarkesa.

GRUAJA — Po si do t'ia bësh?

SHOFERI — Po zbres gruan... Le të vijë me ty,  
Rusto!

RUSTEMI — Po, po, vijnë me linjën. Sa desha  
të ta propozoja, ti e kuptove vetë.

SHOFERI — Ka njeri vallë që nuk e kupton rën-  
dësinë e pjesëmarrjes në stërvitje. Nuk e  
besoj. Hipni, shoqe... Në repart do të arri-  
ni në kohë... Të kënaqur, shokë?

TË GJITHË — Rruga e mbarë!

*Shoferi dhe vajzat dalin.*

## PASQYRA E LËNDËS

Takim në rrugë .....	3
E provoi në kurrizin e tij .....	10
Xha Nazifi rojë .....	16
Rrufeja numër pesëmbëdhjetë .....	21
Traktoristët .....	27
Gogoli i dashurisë .....	32
Dulja punon me norma kolektive .....	40
Lipe Shtogu .....	43
Profesioni ynë, sa i bukur!... ..	48
Masat e Rakos .....	54
Komisioni dorëlëshuar .....	59
Manovrimet e Polikronit .....	67
Niqifori kujdeset për kopertinën .....	72
Pragu i shkollës — kufiri i edukimit .....	78
Sonte do të gatujë Vera! .....	83
Kultura që duket .....	91
U bë puna me dru .....	95
Rrufe nga mali .....	99
Rrugë të mbarë!... ..	118